



Treguesit Kryesorë

	EUR '000		ALL'000		Change ALL
	2016	2015	2016	2015	
Pasqyra e Bilancit					
Asete Totale	245,756	254,714	33,233,585	34,967,025	-4.96%
Portofoli Bruto i Kredisë	158,157	175,706	21,387,633	24,120,982	-11.33%
Portofoli i kredisë Biznes	130,555	133,394	17,654,956	18,312,316	-3.59%
Portofoli i kredisë Individë	27,602	42,312	3,732,677	5,808,666	-35.74%
Provizjonet për Kreditë e Humbura (LLP)	-11,042	-12,328	-1,493,182	-1,692,328	-11.77%
Portofoli Neto i Kredisë	147,116	163,379	19,894,451	22,428,654	-11.30%
Depozita të Klientëve	201,894	207,900	27,302,128	28,540,449	-4.34%
Detyrime në Banka dhe Institucione të tjera (duke përjashtuar PCH)	1,044	2,873	141,226	394,388	-64.2%
Kapitali Total	35,766	36,472	4,836,609	5,006,873	-3.40%
Pasqyra e të ardhurave					
Të Ardhura Operative	11,967	13,120	1,643,939	1,833,554	-10.34%
Shpenzime Operative	11,753	11,638	1,614,485	1,626,472	-0.74%
Fitimi Operativ Para Tatimit	214	1,482	29,454	207,082	-85.78%
Fitimi Neto	64	1,122	8,756	156,858	-94.42%
Raporte Kryesore					
Raporti të Ardhura Kosto	94.73%	74.32%			
Kthimi i Kapitalit	0.18%	3.18%			
Raporti i Kapitalit	16.19%	15.57%			
Statistika Operacionale					
Numri i klientëve	70,576	85,936			-17.87%
<i>Prej të cilëve janë Klientë Biznesi</i>	10,475	15,018			-30.25%
Numri i Kredive Aktive	9,617	14,291			-32.71%
Numri i llogarive	113,236	131,619			-13.97%
Numri i Punonjësve	237	277			-14.44%
Numri i degëve dhe Njësive të Biznesit	18	22			-18.18%

Monedha vendase kundrejt Euros:

2016: 1 EURO = 135.23 LEKË

2015: 1 EURO = 137.28 LEKË

Kursi mesatar i këmbimit kundrejt Euros:

2016: 1 EURO = 137.37 LEKË

2015: 1 EURO = 139.75 LEKË

Treguesit Kryesorë	2
Misioni i Bankës	4
Deklarata Gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e Gjendjes Financiare	8
Adresat dhe Kontaktet	38



Misioni i Bankës

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Ne ofrojmë shërbim cilësor për bizneset e vogla dhe të mesme si dhe për ata individë që zgjedhin të kursejnë me ne. Në veprimet tona, ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën në komunikimin me klientët, nuk promovojmë kredinë konsumatore, përpiqemi të minimizojmë ndikimin tonë negativ në mjedis dhe ofrojmë shërbime financiare të përshtatshme me situatën e klientëve tanë si dhe të bazuara në një analize të përgjegjshme financiare.

Fokusi ynë është ofrimi i shërbimit cilësor për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe u japin një kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë. Ne promovojmë kulturën e kursimit, duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese për klientët tanë dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukimin financiar, sepse besojmë që kursimi sjell qëndrueshmëri dhe siguri për familjet e zakonshme.

Aksionarët tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi, por nuk janë të interesuar vetëm për maksimizimin afatshkurtër të fitimit. Ne investojmë në mënyrë të vazhdueshme në trajnimin e punonjësve tanë, për të krijuar një mjedis pune të kënaqshëm dhe efikas, si edhe për të siguruar shërbim profesional dhe të përshtatshëm për klientët tanë.

Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive përgjatë vitit 2016:

- **Adela Leka – Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive**
- **Ardiola Hristiç – Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive**
- **Besnik Berisha – Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive***

Këshilli Drejtues përgjatë vitit 2016:

- **Borislav Kostadinov (Kryetar i Bordit)**
- **Wolfgang Bertelsmeier**
- **Mimoza Godanci**
- **Jordan Damcevski**
- **Robert Scott Richards**

* Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive deri në nëntor 2016.

Deklarata e Gjithëpërfshirëse

Deklarata Gjithëpërfshirëse

Në kuadër të përcaktimeve dhe parimeve të vendosura në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret e miratimit të administratorëve të tyre” Banka ProCredit sh.a. deklaron se:

Politikat e Shpërblimit

Në bazë të Statutit në fuqi të datës 15.7.2010 të Bankës ProCredit, Anetarët e Këshillit Drejtues, si dhe Anetarët e Komitetit të Kontrollit të Bankës, nuk paguhen për kryerjen e detyrave të tyre por marrin një dietë të përshtatshme për shpenzimet, e cila përcaktohet herë pas here nga Asambleja e Aksionerëve.

Tre Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive të Bankës ProCredit, si drejtuesit më të lartë ekzekutiv dhe në përputhje me profilin e riskut të bankës paguhen në bazë të një pagë mujore fikse shuma bruto e agreguar vjetore e së cilës është 26’822’857 lekë.

Politikat e shpërblimit të bankës konsistojnë në shpërndarjen e pagës fikse mujore për punën në raport me pozicionin, eksperiencën, përgjegjësitë dhe detyrat që ka çdo punonjës, si dhe në mosdhënien e bonuseve shtesë.

Mënyra të tjera të shpërblimit për punonjësit jepen në formën e:

- Kontroll mjekësor falas një herë në vit
- Shpërblimi për lindjen e fëmijës
- Shpërblim për përkujdesjen e fëmijes (për kthimin nga leja e lindjes deri në 1 vjeç)
- Paketa udhëtimi dhe qiraje
- Paketa telefonie
- Dieta në udhëtim

Në zbatim të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv përgjatë veprimtarisë së saj, Banka ProCredit harton dhe zbaton aktet e brëndshme si më poshtë:

- Politika dhe procedura të administrimit të riskut
- Procedura për kriteret e emërimit dhe dokumentacionin për miratimin nga Banka e Shqipërisë të administratorëve të bankës
- Procedura e Përputhshmërisë Ligjore me Rregulloret e Jashtme

Politika e Pagave është në linjë me politikën e pagave të grupit të bankave ProCredit, si dhe përcakton rolin që ProCredit Holding luan në lidhje me politikën e brëndshme. Qëllimi i kësaj politike është të përcaktojë bazat mbi të cilat është ngritur struktura e pagave gjithashtu i është bërë referencë ndryshimeve në pozicione, strukturës organizative të institucionit dhe kërkesave të trajnimeve për çdo grup pagash.

Struktura e pagave të bankës është një komponent thelbësor i politikës së Burimeve Njerëzore. Ajo synon të ofrojë një kornizë të thjeshtë dhe koherente të niveleve të pagave për të gjitha pozicionet në ProCredit gjithashtu edhe rrugët e qarta për zhvillimin e karrierës.

Çdo pozicion në bankë shfaqet në strukturën e pagave me një rang page që përbëhet nga një numër i caktuar i hapave të pagave që mund të përdoren në varësi të performancës së çdo punonjësi.

Parimi i një page fikse (jo të ndryshueshme) riafirmohet me forcë si një element kyç i politikës së pagave të institucionit. Jo vetëm që bonuset e bazuara në performancë janë shfuqizuar, por edhe përfitimet financiare shtesë, të tilla si paga mujore e trembëdhjetë apo e katërbëdhjetë, pagesat e çdo lloji, kupona, shpenzime pushimesh, etj.gjithashtu nuk praktikohen. Kjo bëhet për të siguruar një formë të qëndrueshme të shpërbimit për punonjësit tanë për një afat të gjatë, më tepër se një paketë e paparashikueshme që mund të ndryshohet.

Rritjet vjetore të pagave janë subjekt analize performance individuale të punonjësit, zhvillimi profesional dhe vendimmarrje në Komitetin e Burimeve Njerëzore.

Komiteti i Burimeve Njerëzore orienton zhvillimin e Burimeve Njerëzore në institucion nëpërmjet diskutimit dhe vendimmarrjes së çështjeve strategjike që zakonisht propozohen nga Njësia i Burimeve Njerëzore, Anëtarë të Drejtorise Ekzekutive, anëtarë të Komitetit të Burimeve Njerëzore, si edhe propozime të cilat mund të vijnë nga drejtuesit e Njësive të Biznesit ose Departamenteve/Njësive pranë Zyrave Qendrore. Komiteti i Burimeve Njerëzore zhvillohet 1 herë në muaj.

Pasqyra e Gjëndjes Financiare

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(me raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)



KPMG Albania Shpk
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Kullat Binjake, Godina 1, kati 13
Tiranë, Shqipëri +355(4)2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionerët dhe Këshillin Drejtues të ProCredit Bank Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ProCredit Bank Sh.a. ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet shoqëruese, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2016, të performances së saj financiare dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin tonë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne veprojmë të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (kodi IESBA) të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët, dhe me Kodin e Etikës së Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA-s) të Shqipërisë, së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, të datës 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor dhe organizimin e profesioneve të audituesve dhe kontabilistëve të merituar", i ndryshuar, të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa, Kodin IESBA dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacione të tjera. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në raportin vjetor të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 53 të Ligjit. Nr. 9662, të datës 18 dhjetor 2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe Raportin e Audituesve tanë. Raporti vjetor pritet të na paraqitet pas datës së këtij raporti të audituesve.



Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk përfshin informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim ndonjë formë konkluzioni sigurimi lidhur me të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacione të tjera të identifikuar më lart, kur ato disponohen dhe, duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket të ketë anomali materiale.

Gjatë leximit të raportit vjetor, në qoftë se konstatojmë se ka anomali materiale, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë problemin personave të ngarkuar me drejtimin.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Atyre të Ngarkuar me Drejtimin për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat Drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës për të vazhduar në vijimësi, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë derisa drejtimi të synojë ose të likuadojë bankën ose të pushojë veprimtarinë e tij, ose të mos ketë asnjë alternativë realiste tjetër veç kësaj.

Të ngarkuarit me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë sigurimi i një besueshmërie të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe nxjerrja e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Besueshmëria e arsyeshme nënkupton një nivel të lartë sigurimi, por nuk përbën garanci për zbulimin e ndonjë anomalie materiale nga një auditim i kryer në përputhje me SNA. Anomali mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato në mënyrë të arsyeshme mund të priten të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne japim gjykimin tonë në mënyrë profesionale dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përgjegjshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë. Rreziku i mos zbulimit të ndonjë gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkeljen e kontrollit të brendshëm.



- Të kuptuarit e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës.

- Vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve të ngjashme shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konstatimet mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë dhe, në bazë të dëshmive të marra të auditimit, konstatimin nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesve për dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare, ose, në qoftë se zbulimet të tilla janë të papërshtatshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në dëshmitë e marra të auditimit deri në datën e raportit të audituesve tanë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të bëjnë që Banka të ndalojë vazhdimin e aktiviteteve të saj.

- Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me drejtimin, midis të tjerave në lidhje me , qëllimin e planifikuar , kohën e auditimit dhe konstatimet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

/nënshkrimi/

Heris Jani
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk
“Deshmoret e Kombit” Blvd.
Twin Towers Building I, floor 13
Tiranë, 29 mars 2017
Tirana, Albania

PROCREDIT BANK SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

	Shënime	2016		2015	
		2016	2015	2016	2015
Aktive					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	13	5,839,408	5,577,941	43,181	40,632
Ilua dhe paradhënie institucioneve financiare	14	1,238,954	1,396,303	9,162	10,171
Ilua dhe paradhënie klientëve	15	19,894,451	22,428,654	147,116	163,379
Instrumentet financiare në dispozicion për shitje	16	2,870,306	2,385,973	21,225	17,380
Ndërtesa dhe pajisje	17	1,260,292	1,266,756	9,320	9,228
Aktive jo-materiale	18	133,365	160,980	986	1,173
Kolateralct e marra ne pronesi	19	1,356,262	980,419	10,029	7,142
Investime në Prona	20	100,979	106,202	747	774
Te drejta tatimore të shtyra	12	17,358	20,055	128	146
Talim mbi lëtimin i Shoqërisë i parapaguar	21	42,561	57,281	315	417
Aktive të tjera	22	479,649	586,461	3,547	4,272
Aktive gjithsej		33,233,585	34,967,025	245,756	254,714
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	23	141,226	394,388	1,044	2,873
Detyrime ndaj klientëve	24	27,302,128	28,540,449	201,894	207,900
Borxh i varur	25	697,875	712,116	5,161	5,187
Detyrime të tjera	26	255,747	313,199	1,891	2,282
Detyrime gjithsej		28,396,976	29,960,152	209,990	218,242
Kapitali aksionar					
Kapitali aksionar	27	3,387,148	3,387,148	25,047	24,673
Rezerva Ligjore	27	707,672	699,829	5,233	5,098
Rezerva e Rivlerësimit nga Kurset e Këmbimit		-	-	(101)	(204)
Fitimi i Pashpërndarë		757,962	917,477	5,707	6,887
Rezerva e rivlerësimit		(16,173)	2,419	(120)	18
Totali i kapitalit aksionar		4,836,609	5,006,873	35,766	36,472
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar		33,233,585	34,967,025	245,756	254,714

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqja 6 deri në 49.

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë e përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referojuni shënimit 2 (c)).

Këto Pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Ekzekutiv më 29 mars 2017 dhe janë nënshkruar në emër të Bankës nga

Ardiola Hristic
 Anëtare e Këshillit Drejtues
 /nënshkrimi dhe vula/



Elvira Tartari
 Drejtoreshë e Sektorit të Financës
 /nënshkrimi/

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shënime	Në LEKË'000		Në EURO'000		
	2016	2015	2016	2015	
Të ardhura nga interesat	7	1,631,815	2,181,453	11,879	15,610
Shpenzime për interesat	7	(252,134)	(409,155)	(1,835)	(2,928)
Të ardhura nga interesi, neto		1,379,681	1,772,298	10,044	12,682
Të ardhura nga komisionet	8	313,388	356,641	2,281	2,552
Shpenzime për komisionet	8	(115,539)	(104,308)	(841)	(746)
Të ardhura nga komisionet, neto		197,849	252,333	1,440	1,806
Të ardhura të tjera operative, neto	9	132,205	181,178	890	1,296
Të ardhura nga këmbimet valutore		(5,352)	(17,214)	(39)	(123)
Provizjonet për humbjet nga kreditë	15	(60,444)	(355,041)	(440)	(2,541)
Shpenzime për personelin	11	(453,845)	(519,222)	(3,304)	(3,715)
Shpenzime të tjera operationale	10	(1,160,640)	(1,107,250)	(8,376)	(7,923)
Fitimi neto para tatimit të fitimit		29,454	207,082	215	1,482
Shpenzime për tatim mbi fitimin	12	(20,698)	(50,224)	(151)	(360)
Fitimi për periudhën		8,756	156,858	64	1,122
Të ardhura të tjera përmblendhëse për periudhën:					
Ndryshimi në rezervën e vlerë së drejtë (aktivet financiare të dispon. për shitje)	16	(21,873)	7,661	(162)	55
Të drejta tatimore të shtyra në ndryshimet e rezervës së vlerës së drejtë	12	3,281	(1,149)	24	(8)
		(18,592)	6,512	(138)	47
Totali i të ardhurave (humbjes) përmblendhëse për periudhën		(9,836)	163,370	(74)	1,169

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave përmblendhëse duhet të lexohet në lidhje me shenimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqja 8 deri në 37.

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referojuni shënimit 2 (c)).

PASQYRA FINANCIARE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në LEKË'000	Kapitali aksionar	Rezervat ligjore	Rezerva e Rivlerësimit/(Deficit)	Fitimi pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	3,387,148	590,681	(4,093)	869,767	4,843,503
<i>Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>					
Totali i transaksioneve me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave (humbjeve) përmbledhëse për periudhën					
Ndryshimi në rezervën e vlerës së drejtë (aktivet financiare të dispon. për shitje)	-	-	7,661	-	7,661
Te drejta tatimore të shtyra në ndryshimet e rezervës së vlerës së drejtë	-	-	(1,149)	-	(1,149)
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	6,512	-	6,512
Fitimi për periudhën	-	-	-	156,858	156,858
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën	-	-	6,512	156,858	163,370
	-	109,148	-	(109,148)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	3,387,148	699,829	2,419	917,477	5,006,873
<i>Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>					
Shpërndarja e dividendeve	-	-	-	(160,428)	(160,428)
Totali i transaksioneve me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	(160,428)	(160,428)
Totali i të ardhurave (humbjeve) përmbledhëse për periudhën					
Ndryshimi në rezervën e vlerës së drejtë (aktivet financiare të dispon. për shitje)	-	-	(21,873)	-	(21,873)
Të drejta tatimore të shtyra në ndryshimet e rezervës së vlerës së drejtë	-	-	3,281	-	3,281
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	(18,592)	-	(18,592)
Fitimi për periudhën	-	-	-	8,756	8,756
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën	-	-	(18,592)	8,756	(9,836)
Ndarja e fitimeve të pashpërndara	-	7,843	-	(7,843)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,387,148	707,672	(16,173)	757,962	4,836,609

<i>Në EURO'000</i>	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva e Konvertimit	Rezerva e rivlerësimit	Fitim i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	24,170	4,215	(353)	(29)	6,560	34,563
<i>Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>						
Totali i transaksioneve me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	-	-	-
<i>Totali i të ardhurave (humbjeve) përmblendhëse për periudhën</i>						
Ndryshimi në rezervën e vlerës së drejtë (aktivet financiare të dispon. për shitje)	-	-	-	55	-	55
Të drejta tatimore të shtyra në ndryshimet e reserves së vlerës së drejtë	-	-	-	(8)	-	(8)
Totali i të ardhurave të tjera përmblendhëse për periudhën	-	-	-	47	-	47
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	1,122	1,122
Totali i të ardhurave përmblendhëse për periudhën	503	88	149	-	-	740
Ndarja e fitimeve të pashpërndara	503	88	149	47	1,122	1,909
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	795	-	-	(795)	-
Totali i transaksioneve me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	24,673	5,098	(204)	18	6,887	36,472
<i>Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>						
Shpërndarja e Dividendëve	-	-	-	-	(1,186)	(1,186)
Totali i transaksioneve me pronarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	-	(1,186)	(1,186)
<i>Totali i të ardhurave (humbjeve) përmblendhëse për periudhën</i>						
Ndryshimi në rezervën e vlerës së drejtë (aktivet financiare të dispon. për shitje)	-	-	-	(162)	-	(162)
Të drejta tatimore të shtyra në ndryshimet e reserves së vlerës së drejtë	-	-	-	24	-	24
Totali i të ardhurave të tjera përmblendhëse për periudhën	-	-	-	(138)	-	(138)
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	64	64
Diferencat nga konvertimi	374	77	103	-	-	554
Totali i të ardhurave përmblendhëse për periudhën	374	77	103	(138)	64	480
Ndarja e fitimeve të pashpërndara	-	58	-	-	(58)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	25,047	5,233	(101)	(120)	5,707	35,766

Pasqyra Financiare e Ndryshimeve në Kapital duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqja 8 deri në 37.

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (refero-juni shënimit 2 (c)).

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shënime	Në LEKË'000		Në EURO'000	
	2016	2015	2016	2015
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative				
Fitimi para tatimit i periudhës	29,454	207,082	215	1,482
Rregullime për të rakorduar fitimin para tatimit me fluksin e mjeteve monetare të siguruara nga aktivitetet operative				
Zhvlërësimi i ndërtesave dhe pajisjeve dhe pronës për investim	153,630	136,653	1,136	996
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	33,664	34,642	249	252
Provizjonet për humbjet nga kredia	60,444	355,041	447	2,586
Të ardhurat nga interesi	(1,631,815)	(2,181,453)	(12,067)	(15,891)
Shpenzime për interesat	252,134	409,155	1,864	2,980
Humbje (fitim) nga nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve	(4,683)	8,764	(35)	64
Kthime nga provigjone të tjera	4,801	15,969	36	116
	(1,102,371)	(1,014,147)	(8,155)	(7,415)
Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:				
Rezerva e detyrueshme	30,860	195,273	228	1,422
Hua dhe paradhënie për bankat dhe institucione të tjera financiare	831,488	(292,830)	6,149	(2,133)
Hua dhe paradhënie për klientët	2,428,400	(1,136,552)	17,958	(8,279)
Aktive të tjera	106,810	54,628	790	398
Kolateralet e marra në pronësi	(390,612)	(111,696)	(2,888)	(814)
Detyrime ndaj bankave	(253,182)	(327,090)	(1,872)	(2,383)
Detyrime ndaj klientëve	(1,197,921)	(1,120,253)	(8,858)	(8,160)
Detyrime të tjera	(44,787)	75,837	(333)	552
	408,685	(3,676,830)	3,019	(26,812)
Interesa të arkëtuara	1,707,935	2,249,812	12,630	16,388
Interesa të paguara	(296,505)	(469,827)	(2,193)	(3,422)
Tatim mbi fitimin, i paguar	(5,978)	(23,313)	(44)	(171)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative	1,814,137	(1,920,158)	13,412	(14,017)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet investuese				
Blerja e aktiveve financiare të vlefshme për shitje	(2,731,996)	(2,267,766)	(20,203)	(16,519)
Të ardhurat nga aktivitetet financiare të vlefshme për shitje	2,200,145	3,169,912	16,270	23,091
Të ardhurat nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve	38,047	23,645	281	172
Blerja e aktiveve jo-materiale	(6,049)	(3,067)	(45)	(22)
Blerja e ndërtesave dhe pajisjeve	(175,309)	(224,883)	(1,296)	(1,638)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet investuese	(675,162)	697,841	(4,993)	5,084
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financuese				
Rënie e borxhit të varur	(10,250)	(571,915)	(76)	(4,166)
Dividendë të paguar	(160,428)	-	(1,186)	-
Fluksi monetar neto i përdorur në aktivitetet financuese	(170,678)	(571,915)	(1,262)	(4,166)
Diferenca nga ndryshimi i kursit të këmbimit	-	-	358	714
Rënie në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	968,297	(1,794,232)	7,515	(12,385)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	2,975,628	4,796,860	21,650	34,035
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	3,943,925	2,975,628	29,165	21,650

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqja 8 deri në 37.

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referojuni shënimit 2 (c)).

SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Hyrje

ProCredit Bank Sh.a ("Banka"), e njohur fillimisht si FEFAD Bank Sh.a., u themelua në muajin shkurt të vitit 1999 dhe në muajin mars të atij viti u licencua për të ushtruar aktivitetin e saj si një bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar për individë në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 2 korrik 1998, zëvendësuar më pas nga Ligji nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë". Adresa zyrtare e Bankës është "Rr. Dritan Hoxha, Kutia postare nr. 2395".

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, aksionari i Bankës është shoqëria ProCredit Holding AG & Co. KGaA e cila zotëron 100% të aksioneve. Më 31 dhjetor 2016, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet Drejtorisë Qendrore në Tiranë me 3 degë, 15 pika shërbimi dhe 20 zona vetë-shërbimi (Zona shërbimi 24 orë në ditë, 7 ditë në javë) të cilat ndodhen në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Berat dhe Vlorë.

2. Bazat e Përgatitjes Kontabël

a) Deklaratë për përputhshmërinë rregullative

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe autoriteti i tij paraardhës. Gjithashtu janë zbatuar interpretimet e lëshuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar Ndërkombëtar (KIRFN).

Detajet e politikave të kontabilitetit të Bankës janë përfshirë në Shënimin 3.

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetet financiare të disponueshme për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në LEK, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në të njëjtën më të afërt, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

Shifrat ekuivalente në Euro

Krahas paraqitjes së pasqyrave financiare në LEK, informacioni plotësues në Euro është përgatitur për qëllime informimi të përdoruesve të pasqyrave financiare, duke konvertuar shifrat nga LEK'000 në EUR'000.

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 31 dhjetor 2016 prej 135.23 LEK për 1 Euro (2015: 137.28). Pasqyra e ndryshimeve në kapital nuk është konvertuar me normën historike të këmbimit siç kërkohet nga SNK 21 "Efektet e ndryshimeve në Kursin e Këmbimit". Kapitali aksionar në normë historike këmbimi është 25,699 mijë Euro (shihni Shënimin 27) dhe nuk është dukshëm i ndryshëm shuma 25,047 mijë Euro, siç paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar. Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare janë konvertuar me kursin e këmbimit mesatar për vitin 2016 prej 137.37 LEK për 1 Euro (2015: 139.75).

d) Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës rishikohen çmuarjet si dhe në periudha të tjera në të ardhmen. Informacioni për aspekte të rëndësishme të pasigurive të çmuarjeve dhe gjykimet e rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të madh në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira tek shënimin 4, 5 dhe 6.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Banka në këto pasqyra financiare.

(a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimit të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Për përcaktimin e nor-mës efektive të interesit, Banka vlerëson fluksin e parasë në të ardhmen, duke marrë në konsideratë kushtet kontraktore të instrumentit financiar, por jo humbjet e kredisë në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit përfshijnë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat të cilat paraqiten në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (ATP/OCI) përfshijnë:

- interesat për aktivet financiare dhe detyrimet financiare të cilat maten me koston e amortizuar llogariten në bazë të normës efektive të interesit; dhe
- interesat për investime në letra me vlerë për investime të disponueshme për shitje llogariten në bazë të normës efektive të interesit.

(b) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit (shih (a)). Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit të llogarisë, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve.

Shpenzime të tjera për komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

(c) Qiraja operative

Shpenzimet për qiranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Incentivat e qirasë njihen si pjesë integrale të totalit të shpenzimeve për qiratë gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

(d) Transaksionet e këmbimeve valutore

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit. Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar është diferenca midis koston së

amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës.

Zërat jo-monetarë të cilat maten me koston historike në monedhë të huaj konvertohen me kursin historik të këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat e këmbimit valutor të cilat rezultojnë nga konvertimi njihen përgjithësisht në pasqyrën e të ardhurave.

(e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet për tatimet përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi afatshkurtër

Tatimi afatshkurtër është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatuashme ose humbjen për periudhën dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përlllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë nuk përlllogaritet mbi diferencat e përkohshme të njohjes fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion i cili nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ka ndikim as mbi kontabilizimin si dhe as në të ardhurat e tatuashme apo shpenzimet.

Të drejtat tatimore të shtyra njihen për humbjet e papërdorura tatimore, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat tati-more të zbritshme deri në atë nivel ku është e mundshme që fitimi i tatuashëm në të ardhmen të materializohet. Të drejtat tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogelohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimeve të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen me njëra-tjetrën, nëse një e drejtë e detyrueshme ligjore ekziston për të kompensuar të drejta dhe detyrime tatimore afatshkurtër dhe lidhen me taksat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor për subjekte të njëjta tatimore ose subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë si qëllim të likuidojnë detyrimet dhe të drejtat tatimore afatshkurtra neto ose të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen njëkohësisht.

(iii) Ekspozimi tatimor

Për përcaktimin e vlerës së tatimit afatshkurtër dhe të shtyrë, Banka merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve të sigurta tatimore dhe nëse duhet të paguhet tatime shtesë dhe interesa. Ky vlerësim mbështetet në çmuarjet dhe supozimet dhe mund të përfshijnë një sërë gjykimesh për ngjarje në të ardhmen. Të dhena të reja mund të behen të disponueshme, si rezultat i të cilave Banka do të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të detyrimeve tatimore do të prekin dhe shpenzimin për tatimet për periudhën gjatë të cilës bëhet përcaktimi.

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njihet Huatë dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera finansiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit, për një instrument që nuk matet me vlerë të

drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivitetet financiare

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Aktive të disponueshme për shitje

Shikoni shënimet (g), (h), dhe (i).

Drejtimi i Bankës përcakton klasifikimin e investimeve të saj me njohjen fillestare. Banka nuk ka klasifikuar ndonjë aktiv financiar me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, ndryshe nga garancitë financiare dhe angazhimet e huasë, si të matura me koston e amortizimit. Shikoni shënimet (l) dhe (o).

(iii) Mos-njohja

Aktivitetet financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktiviteti financiar janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktiviteti financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetin financiar ose në të cilin Banka nuk transferon dhe nuk mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë si dhe nuk gëzon kontrollin ndaj aktivitetit financiar.

Për mos njohjen e një aktiviteti financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlera e mbartur që i është caktuar pjesës së aktivitetit që nuk njihet) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (duke përfshirë aktivitetin e ri që është marrë duke i zbritur detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që është njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse, njihet në pasqyrën e të ardhurave. Çdo interes në aktivitetin financiar të transferuar, të cilat kualifikohen për mos-njohje, që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktivitet ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare

Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

(iv) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e aktivitetit ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktiviteti dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar, duke zbritur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(i) Matja me vlerën e drejtë

'Vlera e drejte' është çmimi i cili do të përcaktohet për të shitur një aktivitet ose do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në principal, ose në mungesë të tij, tregu më i favorshëm në të cilin Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyror rrezikun e mos-performancës së tij.

Nëse është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për instrumentin. Një treg konsiderohet si treg aktiv nëse transaksionet për aktivitetet dhe detyrimet ndodhin me një frekuencë dhe në volume të

mjaftueshme për të paraqitur informacion dhe të dhëna për çmimin në mënyrë të vazhdueshme. Në rast se në një treg aktiv nuk ka një çmim të kuotuar, atëherë Banka përdor teknikën e vlerësimit të cilat maksimizojnë përdorimin e informacioneve dhe të dhënave të evidentueshme dhe vëzhgueshme si dhe minimizojnë përdorimin e informacioneve dhe të dhënave jo të evidentueshme dhe të pavëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg duhet të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transakcioni.

Evidenca më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transakcionit - p.sh. vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transakcionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të njëjtë dhe as në bazë të një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregje të evidentueshme dhe të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, e cila rregullohet për të pranuar ndryshimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transakcionit. Për rrjedhojë, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit por jo më vonë se koha kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhëna të evidentueshme dhe të vëzhgueshme në treg ose koha e mbylljes së transakcionit.

Nëse një aktiv ose detyrim i cili matet me vlerën e drejtë, ka një çmim ofertë dhe një çmim kërkesë, atëherë Banka mat pozicionet e aktiveve dhe pozicionet afatgjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicione afatshkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në bazë të kërkesës, e zbritur nga data e parë në të cilën mund të kërkohej pagesa e shumës.

Banka i njej transfertat midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Zhvlerësimi i huave dhe paradhënive

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare janë të zhvlerësuar.

Nëse ekzistojnë fakte objektive që vërtetojnë se ka ndodhur zhvlerësimi i një ekspozimi kredie ose i një portofoli të ekspozimeve të kredisë i cili ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë të aktivitetit financiar (aktiveve), humbjet përkatëse njihen menjëherë. Në varësi të madhësisë së ekspozimit të kredisë, keto humbje llogariten për çdo ekspozim kredie më vete ose vlerësohen së bashku kolektivisht për një portofol të ekspozimeve të kredise. Vlerësimi kolektiv është vendosur për banka me hua homogjene të cilat nuk konsiderohen individualisht të rëndësishme; dhe bankat e aktiveve të cilat janë individualisht të rëndësishme por që nuk rezultuan të zhvlerësuar individualisht. Vlera e mbartur e kredisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të llogarisë së provigjioneve dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Banka nuk i njej humbjet nga ngjarje të pritshme në të ardhmen.

Hua dhe paradhënie të vlerësuar individualisht

Banka vlerëson në fillim nëse ekzistojnë faktet objektive të zhvlerësimit veçmas në mënyrë individuale për aktivet financiare të cilat janë të rëndësishme më vete, dhe veçmas ose në mënyrë kolektive për aktivet financiare të cilat nuk janë të rëndësishme më vete. Ekspozimet e kredisë vlerësohen individualisht të rëndësishme nëse kanë një madhësi të caktuar. Të gjitha ekspozimet e kredisë mbi EURO / USD 30,000 vlerësohen individualisht për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë shenjë zhvlerësimi e cila mund të sjellë një humbje nga zhvlerësimi p.sh. çdo fakt që mund të influen-

cojë aftësinë e klientit për të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Bankës. Kriteret që Banka përdor për të përcaktuar se ekzistojnë fakte objektive për një humbje nga zhvlerësimi përfshijnë si më poshtë vijon:

- moskryerja e pagesave të principalit dhe interesave sipas kontratës, në mënyrë të veçantë ato me mbi 30 ditë vonesë;
- shkelja e kushteve dhe afateve të kredisë;
- fillimi i procedurave të falimentimit ose riorganizimit financiar;
- fillimi i procedurave gjyqësore nga Banka;
- të gjithë ose një pjesë e ekspozimit jashtë bilancit të një klienti tregon shenja zhvlerësimi; çdo informacion specifik për aktivitetin e biznesit të klientit që parashikohet të ketë një ndikim negativ në fluksin e ardhshëm të parasë; dhe
- ndryshimet në mjedisin e tregut të klientit që parashikohen të ketë një ndikim negativ në fluksin e ardhshëm të parasë.

Gjatë përcaktimit të fondit rezervë për zhvlerësim, duhet të merret në konsideratë ekspozimi agregat ndaj klientit dhe shumat e pritshme nga kolaterali i vendosur si garanci.

Në rast se ekzistojnë fakte objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi, vlera e humbjes matet si diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktivitetit financiar (zhvlerësim specifik). Nëse ekspozimi i kredisë ka një normë të ndryshueshme interesit, norma e zbritjes për matjen e humbjes nga zhvlerësimi është norma efektive e interesit aktual. Llogaritja e vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të një aktiviteti financiar i cili është vendosur si garanci pasqyron fluksin e parasë që mund të rezultojë nga mbyllja minus kostot sigurimin dhe shitjen e kolateralit.

Hua dhe paradhënie të vlerësuar kolektivisht

Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit kolektiv, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të kredisë p.sh. sipas numrit të ditëve vonesë. Vonesa prej më shumë se 30 ditë konsiderohet një tregues zhvlerësimi.

Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit për ekspozimet e kredisë individualisht jo të rëndësishme (fondi rezervë për Huatë të zhvlerësuar individualisht të parëndësishme) dhe për ekspozimet e kredisë të pazhvlerësuar (fondi rezervë për Huatë e vlerësuar kolektivisht) bazohet në analizën sasiore të normave të vonesës për portofolet e kredisë me karakteristika të ngjashme risku (analiza e migrimit). Pas analizës sasiore të këtyre të dhënave statistikore, drejtimi i ProCredit Holding përcakton normat e duhura të cilat duhet të përdoren si bazë për fondet e zhvlerësimit sipas portofolit. Këto norma janë subjekt i ri-testimit të përvitshëm.

Flukset e ardhshme të parasë në një grup të aktiveve financiare të cilat vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim përllogariten në bazë të flukseve të parasë kontraktore të aktiveve në grup dhe eksperiencës së humbjes historike për aktive me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë me ato të grupit.

Eksperiencia e humbjes historike rregullohet në bazë të të dhënave aktuale të evidentueshme dhe të vëzhgueshme për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale që nuk cënuan periudhën në të cilën bazohet eksperiencia e humbjes historike dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht. Metodologjia dhe supozimet që përdoren për vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimit dhe përllogaritjeve të humbjes dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Rikthimi i zhvlerësimit

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjes së zhvlerësuar zvogëlohet ose dhe zvogëlimi lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit humbja nga zhvlerësimi që është njohur më parë, kthehet duke rregulluar llogarinë e provigjionit. Shuma e kthimit njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Fshirja e huave dhe paradhënieve

Nëse një hua nuk mund të arkëtohet, ajo fshihet kundrejt provigjoni përkates për zhvlerësimin e huasë. Këto hua fshihen pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme dhe përcaktimit të shumës së humbjes. Rikuperimet e mëvonshme të shumave që janë fshirë më parë njihen në pasqyrën e të ardhurave si pjesë e provigjoni për humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve.

Ekspozimet e kredive të ristrukturuara

Ekspozimet e kredive të ristrukturuara që janë në vonesë ose të zhvlerësuar dhe të cilat konsiderohen individualisht të rëndësishme vlerësohen individualisht (shihni më sipër). Kreditë e ristrukturuara të cilat janë individualisht jo të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim.

Aktivitet e marra në këmbim për Huatë (pronat e marra në zotërim)

Pronat e marra në zotërim përbajnë aktivitet jo-financiare të marra në zotërim të cilat janë përfituar nëpërmjet ekzekutimit të garancive të kredive me probleme dhe paradhënieve të klientëve të cilët nuk gjenerojnë të ardhura qiraje dhe nuk përdoren nga Banka dhe janë planifikuar për shitje brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme, pa ristrukturime të rëndësishme. Aktivitet e marra në zotërim përfshihen tek mjetet e tjera dhe maten me koston dhe vlerën më të ulët neto të realizueshme dhe vlera njihet në pasqyrën e të ardhurave së bashku me të gjitha të ardhurat dhe humbjet nga shitja e tyre.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të disponueshme për shitje

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet. Në rastin e investimeve të kapitalit klasifikuar në kategorinë të disponueshme për shitje, rënia e ndjeshme dhe e madhe në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën koston e saj merret në konsideratë për të përcaktuar nëse aktivitet janë zhvlerësuar. Nëse këto fakte objektive ekzistojnë për aktivitet financiare të disponueshme për shitje, humbja kumulative, e cila vlerësohet dhe matet si diferenca midis koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare të cilat janë njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, hiqet nga zëri i të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për instrumentet e kapitalit nuk kthehen përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e instrumentit të borxhit që klasifikohet në kategoritë e letrës me vlerë të disponueshme për shitje rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas datës së zhvlerësimit, humbja është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se tre muaj ose më pak se data e blerjes, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

(g) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Huatë dhe paradhëniet maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit plus koston e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për rishitjen e aktivitet (ose një aktivitet tjetër të ngjashëm) me një çmim të caktuar fiks në datë të caktuar (marrëveshjet e riblerjes së anasjelltë), marrëveshja kontabilizohet si një hua ose paradhënie, dhe aktivitet në fjalë nuk njihet në pasqyrat

financiare të bankës.

Aktive financiare të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të investimeve njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus koston e tjera të transaksioneve direkte.

Letrat me vlerë të investimeve janë investime jo de-rivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë letrat me vlerë të kapitalit dhe letra me vlerë të borxhit. Letrat me vlerë të borxhit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha letrat me vlerë të disponueshme për shitje maten me vlerën e drejtë pas njohjes fillestare.

Të ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave kur Banka gëzon të drejtën mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave. (shihni shënimet në pikën (f)(vii)).

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shihni shënimet në pikën (f)(vii)) njihen tek pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë të kapitalit. Nëse investimi shitet, gjendja në kapital riklasifikohet në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërtesat dhe pajisjet dhe investimet në prona

Ndërtesat dhe pajisjet dhe investimet në prona paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Koston historike përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së zërave të ndërtesave dhe pajisjeve.

Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivitet, ose njihen si një aktivitet më vete, sipas rastit, në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivitet mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë së cilës janë kryer këto shpenzime.

Vlera e mbartur e ndërtesave dhe pajisjeve dhe investimeve në prona rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Nëse ekzistojnë këto tregues dhe nëse vlera e mbartur tejkalon shumën e përllogaritur që mund të rikuperohet, aktivitet ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare fshihen nga shuma e tyre e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e ndërtesave dhe pajisjeve është shuma më e madhe e vlerës së drejtë duke i zbritur shpenzimet për shitjen e tyre dhe vlerën në përdorim. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Toka dhe aktivitet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve realizohet duke përdorur metodën lineare sipas normave të përcaktuara për koston dhe shpenzimet për pronën dhe pajisjet gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të tyre. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen në bazë të jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve të caktuara sipas tabelës që paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	Jetëgjatësia
Kompjuter dhe pajisje elektronike	5 vjet
Automjete	5 vjet
Mobilje dhe pajisje	10 vjet
Ndërtesat	40 vjet

Përmirësimet e mjediseve me qira zhvlerësohen gjatë periudhës së kontratës së qirasë.

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jetëgjatësia e përdorimit rishikohen dhe rregullohen, sipas rastit, në datën e raportimit. Fitimet dhe shpenzimet për shitjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e mbartur. Këto përfshihen në zërin e të ardhurave të tjera ose në zërin e shpenzimeve të tjera operative (sipas rastit) të

pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Investimet në prona mbahen nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit, ose për të dyja qëllimet. Investimet në prona përfshijnë aktivet për përdorime në të ardhmen për qëllime investimi.

(h) Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivt afatgjata jo-materiale njihen në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivitetit mund të maten në mënyrë të besueshme. Aktivt afatgjata jo-materiale maten dhe vlerësohen fillimisht me kosto. Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata jo-materiale rishikohet për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Aktivt afatgjata jo-materiale përfshijnë programet kompjuterike të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e dobishme prej dhjetë vjet.

(i) Depozitat dhe detyrimet e varura

Depozitat dhe detyrimet e varura përbëjnë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivitetit (ose të një aktiviteti të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje të shitjes dhe riblerjes) marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktiviteti në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

(j) Provigjonet

Një provigjon mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet më besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një normë para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin. Konvertimi i zbritjes njihet si kosto dhe shpenzim financiar.

(k) Përfitimet e punonjësve

Banka operon vetëm me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat gjenerojnë përfitime pensioni për punonjësit. Autoritetet lokale janë përgjegjës për përcaktimin e pragut minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pension. Kontributet e Bankës në planin e pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në momentin e pagesës.

(l) Garancitë financiare dhe angazhimet e huasë

Garancitë financiare janë kontrata që kërkojnë që Banka të realizojë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka ndodhur si rezultat i mungesës së pagesës sipas termave kontraktuale për një instrument borxhi nga një debitor i caktuar. Angazhimet e huasë janë angazhime të qendrueshme për të ofruar kredi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara paraprakisht. Këto angazhime financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar nëse dhe në momentin kur janë të pagueshme.

(m) Kapitali aksionar

(i) Kostot për emetimin e aksioneve

Kostot dhe shpenzimet shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte emetimit të aksioneve të reja paraqiten në kapital si një zbritje nga të ardhurat pa tatimin, neto.

(ii) Primi i aksioneve

Primi i aksioneve përfaqëson vlerën e kontributeve që arkëtohet mbi vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapital për

periudhën gjatë të cilës miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendet për periudhën që deklarohen pas datës së raportimit pasqyrohen si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

(n) Standardet e reja, amendimet dhe interpretimet ende të pa miratuara

Një numër standardesh të reja, amendime të standardeve dhe interpretime ende nuk janë në fuqi dhe efektive për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2016, dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Standardet dhe amendimet që mund të jenë të rëndësishme për Bankën paraqiten si më poshtë vijon. Banka nuk ka në plan t'i miratojë së shpejti këto standarde dhe amendime.

SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 "Instrumentet Financiare": Njohja dhe Vlerësimi. SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së planifikuar të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit për fondin rezervë. Ky standard jep udhëzime të mëtejshme në lidhje me njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare" hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018 pas lejimit të miratimit paraprak. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9. Për shkak të natyrës së operacioneve të Bankës, ky standard pritet të ketë një ndikim të përgjithshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 përcakton një kuadër gjithëpërfshirës për përcaktimin e njohjes së vlerës dhe kohën e njohjes. Ky standard zëvendëson standardin ekzistues udhëzues për njohjen e të ardhurave, përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat për Ndërtimin dhe KIRFN 13 Programet për Besnikërinë e Klientit. SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018 pas lejimit të miratimit paraprak.

Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 15.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është në fuqi për periudhat që fillojnë në dhe pas datës 1 janar 2019, pas lejimit të miratimit paraprak, por vetëm nëse subjekti zbaton SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët. SNRF 16 zëvendëson standardin e mëparshëm për qiratë, SNK 17 Qiratë dhe interpretimet përkatëse. Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpjegimet shoqëruese të qirave për të dyja palët e kontratës, p.sh. klienti ('qiramarrësi') dhe furnitori ('qiradhënësi'). SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare sikundër përcaktohet në SNK 17, dhe në vend të tyre prezanton një model kontabilizimi për një qiramarrës të vetëm. Përmes zbatimit të këtij modeli, një qiramarrës duhet të njoh: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat prej më shumë se 12 muaj, përveç rastit kur vlera e aktivitetit në fjalë është e ulët dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve me qira më vete nga interesat e detyrimeve të qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF mbart tërësisht kriteret kontabël për qiradhënësin në SNK 17. Për këtë arsye, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiratë e saj si qira operative ose qira financiare dhe i kontabilizon ndryshe të dyja llojet e qirave.

Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare të saj që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 16.

Standardet e reja dhe të amendura që vijnë më poshtë nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës. Standardet e mëposhtme në fuqi për periudhat vjetorë të raportimit që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017

- Ndryshimet e SNK 7: Iniciativa e shënimeve shpjeguese
- Ndryshimet e SNK 12: Njohja e Aktiveve Tatimore të shtyra për Humbjet e Pa Realizuara

Standardet e mëposhtme në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018

- Interpretimi KIRFN 22: Transaksionet në valutë dhe Trajtimi i Paradhënieve
- Ndryshimet e SNK 40: Transferimet e Investimeve të Pronës Standardet që vijnë më poshtë, ndryshimet ose interpretimet janë lëshuar nga nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës.
- Përmirësimet Vjetore në Standardet SNRF, Cikli 2014-2016
- Ndryshimet në SNRF 2: Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione
- Ndryshimet në SNRF 4: Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja apo Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe Bashkëpunëtori të tij ose një Sipërmarrjeje të Përbashkët”.

4. Përmbledhjet e gjykimeve kontabël të rëndësishme dhe burimet kryesore të pasigurisë së çmuarjeve

Banka bën gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit ushtrimor pasardhës. Gjykimet dhe çmuarjet vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe në bazë të eksperiencës historike dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në varësi të rrethanave.

Pasiguritë e supozimeve dhe çmuarjeve

Informacioni dhe të dhënat në lidhje me pasiguritë e supozimeve dhe çmuarjeve të cilat kanë një risk të konsiderueshëm dhe mund të kërkojnë rregullim material në vitet në vijim, paraqitet më poshtë për zhvlerësimin e instrumenteve financiare dhe në shënimin 6 - Përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare.

(i) Zhvlerësimi për humbjet nga kreditë

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën çdo tremujor. Për të përcaktuar nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Banka bën gjykimet nëse ekzistojnë të dhëna të vëzhgueshme dhe evidentueshme të cilat tregojnë se ka një rënie të matshme në fluksin e ardhshëm të parasë së parashikuar nga portofoli i kredisë përpara se rënia mund të identifikohet me një hua individuale të atij portofoli. Ky fakt mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme dhe evidentueshme të cilat tregojnë se ka patur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagimit të huamarrësve në një grup, ose në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale të cilat lidhen me mospagesat për aktivet në Bankë.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë

Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet e bilancit paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Mjetet monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,839,408	5,577,941
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,238,954	1,396,303
<i>Hua dhe paradhënie klientëve :</i>		
Biznesi	16,913,571	18,253,929
Bujqësia	1,765,996	2,707,308
Strehimi	899,072	1,006,368
Konsumatorë	206,574	308,726
Të tjera	109,238	152,323
	19,894,451	22,428,654
Instrumente financiare të disponueshme për shitje	2,870,306	2,385,973
Aktive të tjera financiare	326,340	467,161
<i>Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet jashtë bilancit paraqiten si më poshtë vijon:</i>		
Angazhimet e huasë dhe detyrime të tjera të lidhura të kredisë	2,092,347	2,381,333
Garancitë financiare	511,360	737,934
Totali	32,773,166	35,375,299

Drejtimi i Bankës përdor çmuarjet në bazë të eksperiencës së humbjeve historike për aktive me karakteristika të riskut të kredisë dhe fakte objektive të zhvlerësimit të ngjashëm me kreditë e portofolit gjatë planifikimit të fluksit të ardhshëm të parasë. Metodologjia dhe supozimet që përdoren për të vlerësuar shumën dhe kohën e fluksit të ardhshëm të parasë rishikohen rregullisht për të zvogëluar diferencat midis çmuarjeve të humbjes dhe eksperiencës së humbjeve aktuale.

(ii) Zhvlerësimi i investimeve në letra të disponueshme për shitje

Banka përcakton se investimet në letra me vlerë të disponueshme për shitje zhvlerësohen në rast se ka një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e saj. Ky vendim për të përcaktuar çfarë është e rëndësishme ose e tejzgjatur kërkon gjykim. Gjatë gjykit, Banka vlerëson midis faktorëve të tjerë, luhatshmërinë e zakonshme të çmimit të aksioneve. Gjithashtu, zhvlerësimi do të jetë i përshtatshëm nëse ka fakte të përqesimit të situatës financiare të investuesit, industrisë dhe ecurisë së sektorit, ndryshime në teknologji dhe të flukseve operacionale dhe financiare të parasë.

(iii) Vlera e aktiveve të marra në pronësi

Banka ka miratuar një politikë në lidhje me vlerat e drejta të aktiveve të marra në pronësi të cilat maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerësuesve të jashtëm të pavarur të pronave të cilët kanë kualifikimet e nevojshme të pranuar statutores profesionale, e cila në vijim rishikohet nga Drejtimi i Bankës për të dhëna të rëndësishme që nuk janë të vëzhgueshme dhe të gjitha rregullimet e nevojshme për fshirjen e tyre.

5. Administrimi i riskut financiar

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj një numri risqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e disa niveleve të riskut ose kombinimin e risqeve. Ndërmarrja e riskut është thelbësore për aktivitetin e biznesit financiar dhe risqet operacionale janë një pasojë e paevitueshme e zhvillimit të biznesit.

Qëllimi i Bankës është të arrijë një ekuilibër dhe balancë të përshtatshme midis riskut dhe përfitueshmërisë si dhe të minimizojë efektet e mundshme të pafavorshme në performancën financiare të Bankës.

Politikat e Bankës për administrimin e riskut janë hartuar në funksion të identifikimit dhe analizës së këtyre rreziqeve, përcaktimit të limiteve dhe kontrolleve të përshtatshme të riskut, për të monitoruar risqet dhe respektimin e limiteve nëpërmjet sistemeve informatike të besueshme dhe të përditësuara. Banka rishikon në mënyrë sistematike politikat dhe sistemet për administrimin e riskut për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe zhvillimin e praktikës më të mirë.

Administrimi i riskut realizohet kryesisht nga Departamenti i Administrimit të Riskut dhe Departamenti i Riskut të Kredisë të cilët punojnë në bazë të politikave për administrimin e riskut të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues paraqet parimet me shkrim për administrimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politikave me shkrim të cilat mbulojnë fusha të caktuara si risku i kredisë, risku i këmbimit valutor, risku i normës së interesit dhe risku i likuiditetit. Gjithashtu, kontrolli i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të administrimit të riskut dhe mjedisin e kontrollit. Banka është subjekt i riskut të kredisë përmes aktiviteteve të kreditimit dhe në rastet e lëshimit të letër kredive dhe garancive në favor të klientëve.

Në këtë aspekt, risku i kredisë për Bankën buron nga mundësia që kundërpalë të ndryshme nuk do të përmbushin detyrimet e tyre kontraktore. Administrimi i ekspozimeve ndaj riskut të kredisë të huamarrësve realizohet nëpërmjet analizës së besueshmërisë së klientëve dhe përcaktimit të nivelit të vlerësimit dhe klasifikimit. Ekspozimi ndaj riskut të kredisë gjithashtu administrohet pjesërisht nëpërmjet marrjes së kolateraleve dhe garancive

(a) Risku i kredisë

Banka ekspozohet ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të kundërpalës, Banka do të pësojë humbje financiare. Risku i kredisë është risku më i rëndësishëm për aktivitetin e biznesit të Bankës, për rrjedhojë drejtimi i Bankës administrohet me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredisë lindin kryesisht në aktivitetin e kredidhënies të cilat përfshijnë hua dhe paradhënie, dhe aktivitete investimi të cilat sjellin depozita dhe letra me vlerë të borxhit në portofolin e aktiveve të Bankës.

Risku i kredisë ekziston gjithashtu në instrumentet financiare jashtë bilancit si letër kredi, garanci dhe angazhime kredie. Administrimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për hua dhe paradhënie janë përqendruar në Departamentin e Administrimit të Riskut, ndërsa risku ndërbankar për depozitat dhe letrat me vlerë të borxhit janë përqendruar në Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Administrimit të Riskut.

Të gjitha departamentet që janë përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë, raportojnë rregullisht në Këshillin Administrativ dhe në Këshillin Drejtues.

(i) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacionin dhe të dhënat për cilësinë e kredisë së aktiveve financiare dhe provigjonin për humbjet nga zhvlerësimet që ruan banka për këto aktive.

Tabela e mëposhtme paraqet skenarin e rastit më të keq të ekspozimeve të riskut të kredisë të Bankës më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, pa marrë në konsideratë kolaterale të mban Banka dhe përmirësimet e tjera të kredisë bashkëlidhur. Për aktivet dhe mjetet financiare, ekspozimet e paraqitura më poshtë përfaqësojnë vlerat e mbartura neto siç raportohen në pasqyren e pozicionit financiar.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë

Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet e bilancit paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Mjetet monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,839,408	5,577,941
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,238,954	1,396,303
Hua dhe paradhënie klientëve:		
Biznesi	16,913,571	18,253,929
Bujqësia	1,765,996	2,707,308
Strehimi	899,072	1,006,368
Konsumatorë	206,574	308,726
Të tjera	109,238	152,323
	19,894,451	22,428,654

Instrumente financiare të disponueshme për shitje		
	2,870,306	2,385,973
Aktive të tjera financiare		
	326,340	467,161
Ekspozimet e riskut të kredisë për jashtë bilancit paraqiten si më poshtë vijon:		
Angazhimet e huasë dhe detyrime të tjera të lidhura të kredisë		
	2,092,347	2,381,333
Garancitë financiare		
	511,360	737,934
Totali	32,773,166	35,375,299

Ne e përcaktojmë riskun e paracaktuar të kredisë nga ekspozimet kreditore të klientit, si riskun e humbjeve për shkak të një mospërmbushjes së mundshme të detyrimeve të pagesës kontraktore të lidhura me një ekspozim të kreditit të klientit. Administrimi i riskut të paracaktuar të kredisë nga ekspozimet kreditore të klientit është i bazuar në një zbatim të plotë të parimeve të kreditimit të bankës:

- analiza intensive të kapacitetit të borxhit të klientëve të Bankës
- dokumentim i kujdesshëm i vlerësimit të riskut të kredisë, duke siguruar se analiza e kryer mund të kuptohet nga palët e treta të mirëinformuara
- shmangia rigoroze e mbingarkimit të klientëve tanë me borxh
- ndërtimin e një marrëdhënie personale dhe afatgjatë me klientin dhe mbajtjen e kontakteve të rregullta
- monitorim i afërt i pagesave të kredisë dhe treguesve të paralizimit të hershëm
- duke praktikuar menaxhimin e ngushtë të borxheve të prapambetura
- duke ushtruar mbledhjen e rreptë të kolateralit në rast vonese
- duke investuar në staf të trajnuar mirë dhe shumë të motivuar
- zbatimin e proceseve të dizajnuara me kujdes dhe të mirë-dokumentuara
- aplikimi rigorozi i "parimit të kontrollit të dyfishtë".

Diferencimi midis ekspozimeve individuale të rëndësishme dhe të parëndësishme të kreditit çon në procese të ndryshme në kreditimin për llojet e ndryshme të ekspozimeve kreditore - proceset që janë demonstruar në të kaluarën për të siguruar një menaxhim efektiv të riskut të paracaktuar të kredisë. Proceset dLEKohen kryesisht në drejtim të ndarjes së detyrave, e cila është zbatuar plotësisht për ekspozimet e rëndësishme individuale të kredisë që janë relevante për riskun dhe një specializim për ekspozimet e rëndësishme individuale të kredisë jo relevante për riskun. Për ekspozimet e rëndësishme individuale të kredisë, pikënisja e analizës është informacioni i mbledhur nga klienti, duke filluar nga pasqyrat e audituara financiare deri tek vetë-deklarimet. Kriteret kryesore për vendimet e ekspozimit të kredisë janë të bazuara në gjendjen financiare të klientit; në veçanti për ekspozimet individuale të parëndësishme të kreditit, plotësuar nga një rishikim i fondeve likuide dhe vlerësimin e aftësisë kreditore të klientit. Së fundi, kërkesat për kolateral janë përgjithësisht më të larta për ekspozimet e rëndësishme individuale të kredisë.

Si një rregull i përgjithshëm, sa më e ulët sasia e ekspozimit të kredisë, aq më i fortë është dokumentacioni i paraqitur nga klienti, sa më i shkurtër afati i ekspozimit të kredisë, sa më e gjatë historia e klientit me bankën dhe më i lartë qarkullimi i klientit me banka, më të ulta do të jenë kërkesat për kolateral.

Procesi i vendimarrjes siguron se të gjitha vendimet e kreditit për ekspozimet e rëndësishme individuale janë marrë nga një komitet krediti. Si parim i përgjithshëm, ne e konsiderojmë shumë të rëndësishme për të siguruar që biznesi ynë i kreditimit është kryer në bazë të udhëzimeve organizative që ofrojnë për rregullat përkatëse që rregullojnë strukturat organizative dhe procedurat operative; përshkrimet e punës që përcaktojnë detyrat përkatëse; një ndarje të qartë të autoritetit vendimmarrës; dhe një përcaktim të qartë të përgjegjësisive.

Ekspozimet e kredisë në vonesë janë përcaktuar si ekspozime kreditore për të cilat interesi kontraktual dhe / ose pagesat e principalit janë vonuar. Cilësia relativisht e lartë e portofolit të kredisë pasqyron zbatimin e parimeve të mësipërme të kreditimit, rezultatet e ndjekjes së treguesve të hershëm të paralajmërimit dhe monitorimin e duhur, në mënyrë të veçantë nga ekspozimet e rëndësishme individuale të kreditit tonë. Ky është një element i rëndësishëm i strategjisë sonë për menaxhimin e pagesave të prapambetura në mjedisin aktual të vështirë ekonomik që po prek klientët tanë. Ne ndjekim në mënyrë rigorozë mos-kthimin e pagesave të ekspozimeve tona të kreditit, e cila në mënyrë tipike lejon për identifikimin e shpejtë të çdo potenciali në rritje për mungesë në një ekspozim të kredisë. Ne zbatojmë rregulla të rrepta në lidhje

me ekspozimet e kreditit për të cilat, sipas mendimit tonë, nuk ka perspektivë realiste se ekspozimi i kreditit do të paguhet dhe ku zakonisht realizimi i kolateralit ose ka përfunduar, ose rezultati i procesit të realizimit është i pasigurt. Përpjekjet tona për rikthim dhe mbledhje kryhen nga punonjës të specializuar, në mënyrë tipike me një historik ligjor apo në kreditim. Efektiviteti i këtij menaxhimi të ngushtë të riskut të kredisë është reflektuar në norma relativisht të ulta të pagesave të prapambetura që shfaqin portofolet tona të kredisë.

Ne vijim paraqiten Huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe provigjonet e zhvlerësimit për çdo kategori të brendshme të ditë vonesave të Bankës:

	2016		2015	
	Hua dhe paradhënie	Provigjoni për zhvlerësimin	Hua dhe paradhënie	Provigjoni për zhvlerësimin
Zhvlerësimi specifik	1,615,638	(402,776)	2,282,626	(534,014)
Vonesa 0-7 ditë	16,464,630	(344,886)	19,626,127	(392,629)
Vonesa 8-30 ditë	2,446,421	(66,658)	1,305,336	(40,875)
Vonesa 31-90 ditë	97,325	(29,679)	103,760	(38,814)
Vonesa 91-180 ditë	94,440	(58,913)	113,327	(68,315)
Mbi 180 ditë	669,179	(590,270)	689,806	(617,681)
	21,387,633	(1,493,182)	24,120,982	(1,692,328)

Kategoritë e zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë vijon:

	2016		2015	
	Hua klientëve	Hua bankave	Hua klientëve	Hua bankave
As me vonesë dhe as i zhvlerësuar	16,144,002	1,238,954	19,228,256	1,396,303
Me vonesë por i pa zhvlerësuar	3,627,993	-	2,610,100	-
Zhvlerësuar individualisht	1,615,638	-	2,282,626	-
Bruto	21,387,633	1,238,954	24,120,982	1,396,303
Duke zbritur: provigjonin për zhvlerësim	(1,493,182)	-	(1,692,328)	-
Neto	19,894,451	1,238,954	22,428,654	1,396,303

Zhvlerësimi dhe provigjonet

Provigjonet e zhvlerësimit njihen për qëllime të raportimit financiar vetëm për humbjet që janë shkaktuar në datën e raportimit të bazuar në dëshmi objektive të zhvlerësimit (shih politikën e kontabilitetit 3. (f) (vii)).

Politika e Bankës kërkon rishikimin e asetëve financiare individuale që janë mbi pragjet e materialitetit të paktën një herë në vit ose më rregullisht kur rrethanat e veçanta e kërkojnë atë. Tolerancat e zhvlerësimit në llogaritë e vlerësuar individualisht, përcaktohen nga një vlerësim i humbjes së pësuar në datën e bilancit mbi një bazë rast pas rasti, dhe aplikohen për të gjitha llogaritë individuale të rëndësishme. Vlerësimi normalisht përfshin kolateralin e mbajtur (duke përfshirë edhe ri-konfirmimin e zbatueshmërisë së tij) dhe arkëtimet e parashikuara për atë llogari individuale. Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit të një grupi aktivesh financiare është i bazuar në një analizë sasiore të normave historike të paracaktuara për portofolin e huave me karakteristika të ngjashme risku. Normat sasiore të paracaktuara të llogaritura në këtë mënyrë i janë nënshtruar një analize cilësore (analiza migrimit).

Sipas metodologjisë së brendshme Banka do të përcaktojë provigjione të humbjes së huasë në përputhje me ndarjen e ekspozimeve kreditore në tri kategori të ndryshme:

- Zhvlerësimi Specifik Individual
- Provigjonet e bazuara në portfole
- Provigjone specifike për një shumë të vetme

Zhvlerësimi specifik individual: Në këtë kategori, Banka do të provigjionojë të gjitha ekspozimet e rëndësishme individuale të kreditit që janë zhvlerësuar në bazë të numrit të ditëve vonesë (më shumë se 30 ditë vonesë).

Zhvlerësimi-bazuar në Portfolio: Në këtë kategori, Banka do të provigjionojë të gjitha ekspozimet kreditore (individualisht të rëndësishme dhe individualisht të parëndësishme), që nuk tregojnë shenja objektive të zhvlerësimit.

Provigjone specifike për një shumë të vetme: provigjonet e humbjeve të huasë janë të përcaktuara për ekspozimet kreditore individuale të parëndësishme që janë zhvlerësuar në bazë të numrit të ditëve vonesë (më shumë se 30 ditë vonesë).

Politika e Bankës kërkon rishikimin e kredive individuale dhe paradhëniet për klientët që janë mbi pragun e materialitetit prej 30 mijë euro ose 30 mijë USD (2015: 30 mijë euro ose 30 mijë USD) të paktën çdo vit, ose kur rrethanat e veçanta kërkojnë atë. Tolerancat e zhvlerësimit në llogaritë e vlerësuar individualisht përcaktohen nga një vlerësim i humbjes së pësuar në datën e bilancit mbi një bazë rast pas rasti, dhe aplikohen për të gjitha llogaritë individuale të rëndësishme. Vlerësimi normalisht përfshin kolateralin e mbajtur (duke përfshirë edhe ri-konfirmimin e zbatueshmërisë së tij) dhe arkëtimet e parashikuara për llogarinë individuale. Të gjitha Huatë dhe paradhëniet që nuk janë as me vonesë dhe as të zhvlerësuar klasifikohen në kategorinë e parë të klasifikimit dhe vlerësimit të Bankës.

Më poshtë paraqitet një analizë e huave dhe paradhënieve standarde për klientët sipas industrisë dhe cilësisë së kredisë.

Hua standarde	Biznesi	Bujqësore	Strehimi	Klienti	Të tjera	Totali
2016	13,692,804	1,385,959	799,987	184,853	100,399	16,144,002
2015	15,530,878	2,400,084	878,967	273,931	144,396	19,228,256

Kategoria Standarde lidhet me Huatë 'As me vonesë as të zhvlerësuar' për të cilat nuk është identifikuar ndonjë evidencë zhvlerësimi. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 nuk ka kredi të shqyrtuara në mënyrë specifike për zhvlerësim.

Huatë me vonesë por jo të zhvlerësuar

Huatë me vonesë por jo të zhvlerësuar janë ato kredi për të cilat pagesa e interesave kontraktor dhe principalit janë me vonesë, por Banka beson së zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të garancisë/kolateralit të disponueshëm dhe/ose fazës së arketimit të shumave që i detyrohen Bankës.

Më poshtë paraqitet një analizë e huave dhe paradhënieve për klientët sipas industrisë dhe cilësisë së kredisë:

2016	Biznesi	Bujqësore	Strehimi	Klienti	Të tjera	Totali
As me vonesë as të zhvlerësuar	13,692,804	1,385,959	779,987	184,853	100,399	16,144,002
Me vonesë por jo të zhvlerësuar	2,921,102	434,238	169,683	85,958	17,012	3,627,993
Individualisht të zhvlerësuar	1,429,441	158,464	26,136	-	1,598	1,615,639
	18,043,347	1,978,661	975,806	270,811	119,009	21,387,634
Duke zbritur: provigjonin për zhvlerësim	(1,129,775)	(212,665)	(76,735)	(64,237)	(9,771)	(1,493,183)
Neto	16,913,572	1,765,996	899,071	206,574	109,238	19,894,451

2015	Biznesi	Bujqësore	Strehimi	Klienti	Të tjera	Totali
As me vonesë as të zhvlerësuar	15,530,878	2,400,084	878,967	273,931	144,396	19,228,256
Me vonesë por jo të zhvlerësuar	1,919,750	381,880	190,502	101,413	16,555	2,610,100
Individualisht të zhvlerësuar	2,054,495	188,901	39,226	-	4	2,282,626
	19,505,123	2,970,865	1,108,695	375,344	160,955	24,120,982
Duke zbritur: provigjonin për zhvlerësim	(1,251,193)	(263,557)	(102,328)	(66,617)	(8,633)	(1,692,328)
Neto	18,253,930	2,707,308	1,006,367	308,727	152,322	22,428,654

Hua dhe paradhënie për klientët të zhvlerësuar individualisht

Më poshtë jepet një ndarje e huave dhe paradhënieve bruto të zhvlerësuar individualisht së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit përkatës të mbajtur nga Banka si siguri.

31 dhjetor 2016	Biznesi	Bujqësore	Strehimi	Klienti	Të tjera	Totali
Hua të zhvlerësuar individualisht	1,429,441	158,464	26,136	-	1,597	1,615,638
Vlera e drejtë e kolateralit	1,303,595	147,970	25,528	-	-	1,477,093

31 dhjetor 2015	Biznesi	Bujqësore	Strehimi	Klienti	Të tjera	Totali
Hua të zhvlerësuar individualisht	2,054,495	188,901	39,226	-	4	2,282,626
Vlera e drejtë e kolateralit	1,995,242	187,753	36,009	-	-	2,219,004

Vlera e drejtë e kolateraleve e zbuluar më sipër përcaktohet nga vlerësues të certifikuar lokalë dhe përfaqëson vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të aseteve.

Hua me afate të rinegociueshme

Hua me afate të rinegociueshme janë hua të cilat janë strukturuar për shkak të përkeqësimit të pozicionit financiar të huamarrësit dhe aty ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të konsiderohen ndryshe. Vendimi për ristrukturim është subjekt i sa me poshtë vijon:

- ristrukturimi rrit probabilitetin që huamarrësi do të ketë mundësi të ripaguj ekspozimin e kredisë
- plani i ri i kthimit të kredisë është në përputhje me kapacitetin e pagimit aktual dhe të ardhshëm të huamarrësit

- huamarrësi ofron kolateral shtesë si garanci, nëse është e mundur dhe e përshtatshme.

Në varësi të llojit të ristrukturimit (standard ose zhvlerësim), ekspozimi i huasë mund të klasifikohet ose jo në një kategori më të mirë në bazë të ecurisë së ekspozimit. Huatë e zhvlerësuar të ristrukturuara qëndrojnë në të njëjtën kategori, të pavarura nga performanca pas ristrukturimit.

	2016		2015	
	Shuma e papaguar	Toleranca për zhvlerësim	Shuma e papaguar	Toleranca për zhvlerësim
Biznesi	490,802	38,813	908,757	93,475
Bujqësore	131,715	6,795	88,647	9,820
Strehimi	1,955	138	16,865	1,532
Klienti	1,712	230	3,346	798
Totali	626,184	45,976	1,017,615	105,625

Politika e Fshirjes së huasë

Banka fshin një hua/gjendje të letrave me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga zhvlerësimi) nëse përcaktohet dhe vendoset se huatë/letrat me vlerë nuk mund të arkëtohen. Ky vendim merret pas analizës së informacionit si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit / emetuesit sipas të cilës huamarrësi/emetuesi nuk ka mundësi të tjera për të paguar detyrimin, ose të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të ripaguar të gjithë ekspozimin. Sa më e vogël të jetë shuma e papaguar, sa më i madh të jetë numri i vonesave dhe sa më të mëdhenj të jenë pasiguritë shoqëruese (si mjedisi ligjor i paparashikueshëm), aq më të vogla do të jenë mundësitë për rikuperimin e huasë nga ana e Bankës. Kthimi i huave të fshira më parë nga Banka arrin vlerën LEK 9,284 mijë në 2016 (2015: LEK 87,393 mijë).

Ekspozimet ndë-bankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Administrimit të Riskut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare vetëm me banka lokale dhe ndërkombëtare të sigurta. Përpara fillimit dhe vendosjes së një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, drejtimi dhe Departamenti i Administrimit të Riskut zhvillon një analizë të situatës financiare të institucionit. Ecuria financiare e kundërpalëve monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, të gjitha bankat korrespondente si dhe emetuesit e obligacioneve ku banka ka ekspozime investimi monitorohen vazhdimisht për klasifikimet dhe vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit dhe vlerësimit si: Standard & Poor's (S&P), Fitch and Moody's. Si një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, në përgjithësi administrimi i riskut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave të mos tejkalojë limitet rregullatore ose limitet e brendshme të përcaktuara nga drejtimi i Bankës. Kthimi i huave të fshira më parë nga Banka arrin vlerën LEK 9,284 mijë në 2016 (2015: LEK 87,393 mijë).

Më 31 dhjetor	2016	2015
BBB	946,757	-
A	-	1,374,537
N/A	270,019	-
Totali (Shihni Shënimin 14)	1,216,776	1,374,537

Aktive Financiare të disponueshme për shitje

Ekspozimi ndaj letrave me vlerë të borxhit rregullohet me Politikën dhe Procedurat e Thesarit. Investimet lejohen vetëm në letra me vlerë likuide të cilat kanë klasifikime krediti minimal (AA-). Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël neto e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar. Investimet në letra me vlerë të borxhit janë me bankat qendrore apo institucionet e tjera financiare të vlerësuar siç detajohet më poshtë:

Klasifikimet më 31 dhjetor	2016	2015
AAA-	-	138,379
AAA	136,472	-
B	-	2,247,594
B+	2,733,834	-
Totali	2,870,306	2,385,973

Angazhimet e kredisë dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguaj nëse thirret garancia, e cila mund të jetë shumë më e madhe se shuma që njihet si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kredisë përbën shumën e plotë të angazhimit (Shihni Shënimin 28).

(ii) Kontrolli i limitit të riskut dhe politikat e zbutjes së riskut

Banka administron limitet dhe kontrollon përqendrimet e riskut të kredisë kudo ku ato identifikohen në mënyrë të veçantë për kundërpalët individë dhe grupet si dhe për filialet.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që merr përsipër duke përcaktuar limitet për shumën e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës, ose një grup huamarrësish, dhe sipas segmenteve gjeografike dhe të industrisë. Këto rreziqe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme dhe në bazë të një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse konsiderohet e nevojshme. Limitet për nivelin e riskut të kredisë sipas produktit dhe sektorit të industrisë miratohen nga Këshilli Drejtues.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë administrohet gjithashtu përmes analizës sistematike të mundësisë së huamarrësve dhe huamarrësve potencial për të plotësuar detyrimet për pagimin e interesave dhe kapitalit si dhe duke ndryshuar limitet e kredisë sipas rasis. Kontrollat e tjera dhe masat për zbutjen e riskut paraqiten në mënyrë të detajuar më poshtë.

Banka zbaton një game të gjerë politikash dhe praktikash për të zbutur dhe zvogëluar riskun. Politika dhe praktika më tradicionale është marrja e garancisë për paradhëniet e fondeve, e cila është një praktikë e zakonshme. Banka zbaton udhëzimet mbi pranueshmërinë e kategorive të veçanta të kolateralit ose zbutjen dhe reduktimin e riskut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për kreditë dhe paradhëniet janë si më poshtë vijon:

- garanci në mjete monetare dhe garanci bankare (kolateral me mjete monetare),
- hipotekë mbi prona rezidenciale/për banim;
- garanci mbi aktivet e biznesit si mjedise, inventari dhe arkëtime në llogari.

Huatë për korporatat dhe individët garantohen në përgjithësi; paradhëniet bankare për individët dhe kartat e kreditit që lëshohen për individët garantohen me mjete monetare (kolateral cash) ose lloje të tjera kolaterali të përcaktuara me vendim të komiteteve të kredisë.

Gjithashtu për të minimizuar dhe zvogëluar humbjen e kredisë, Banka do të kërkojë kolateral shtesë nga kundërpala menjëherë sapo të evidentohen treguesit e zhvlerësimit për kreditë dhe paradhëniet përkatëse të individëve.

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga banka në mënyrë individuale. Vlera që rezulton nga vlerësimi përfaqëson vlerën e vërtetë të tregut. Gjithashtu të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit merren në konsideratë për vlerësimin e provigjionimit për zhvlerësimin individual.

Vlerat e kolateralit të grupuara sipas ekspozimeve përkatëse paraqiten si më poshtë vijon:

	2016		2015	
	Vlera e mbartur e aktivit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbartur e aktivit	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipotekë dhe të tjera	18,080,010	16,185,275	20,488,066	20,781,969
Kolateral tjetër	1,636,589	563,474	1,683,678	523,386
I pasiguruar	177,852	-	256,910	-
Totali	19,894,451	16,748,749	22,428,654	21,305,355

(iii) Përqendrimi i riskut të kredisë

Përqendrimet linden kur një numër kundërpalesh angazhohen në aktivitete të ngjashme biznesi, ose në aktivitete në të njëjtë rajon gjeografik, ose kanë karakteristikë të ngjashme ekonomike si rezultat i të cilave aftësia e tyre për të përmbushur dhe plotësuar detyrimet kontraktore do të preket dhe cenohet njësoj nga ndryshimet e kushteve ekonomike, politike ose kushte të tjera. Përqendrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të ecurisë së bankës kundrejt zhvillimeve që cenojnë një industri të caktuar ose një vendndodhje specifike.

Sektorët gjeografikë

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ndarja e ekspozimit kryesor të kredisë së Bankës në vlerën e tyre bruto, të klasifikuar sipas rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Banka ka bërë shpërndarjen e ekspozimeve për rajonet sipas vendit të rezidencës të kundërpalesë të saj.

2016	Vendet e OECD-së	Shqipëria	Totali
Llogari me Bankën Qendrore	-	2,588,050	2,588,050
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	968,935	270,019	1,238,954
Hua dhe paradhënie për klientët	-	19,894,451	19,894,451
Aktive financiare të disponueshme për shitje	136,472	2,733,834	2,870,306
Aktive të tjera financiare	-	326,640	326,340

2015	Vendet e OECD-së	Shqipëria	Totali
Llogari me Bankën Qendrore	-	2,645,337	2,645,337
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,396,303	-	1,396,303
Hua dhe paradhënie për klientët	-	22,428,654	22,428,654
Aktive financiare të disponueshme për shitje	138,379	2,247,594	2,385,973
Aktive të tjera financiare	-	467,162	467,162

Huatë dhe paradhëniet për klientët bazuar në sektorë të veçantë të industrisë në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten më poshtë

Sektori i industrisë	31 dhjetor			
	2016	%	2015	%
Tregti	8,615,994	43	9,382,983	42
Industri dhe prodhim tjetër	4,209,097	21	4,217,055	19
Ndërtim	492,293	3	374,392	2
Transport	533,590	3	561,518	2
Shërbime	484,154	2	7,285,420	32
Të tjera	5,559,323	28	607,286	3
Totali	19,894,451	100	22,428,654	100

(b) Risku i Tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja dhe spread-et e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/kreditorit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e mbajtjes së instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrevë të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin mbi riskun.

(i) Risku i kursit të këmbimit

'Risku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të ndryshojë për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit. Banka nuk ka si qëllim të përfitojë nga transaksionet spekulative, ajo në perpjekjet e saj mban pozicionet e hapura të këmbimit valutor në çdo kohë afër zeros.

Limitet e pozicioneve të hapura valutore dhe kapaciteti i ndërmarrjes së riskut nga ana e Bankës është e përcaktuar dhe parashikuar në politikat e tyre përkatëse të cilat miratohen nga Këshilli Drejtues, dhe rishikohen çdo javë nga Departamenti i Administrimit të Riskut. Gjithashtu, Banka respekton në çdo kohë limitet rregullatore. Kursi i këmbimit zyrtar për monedhat kryesore që është përdorur për këmbimin e zërave të bilancit që janë në monedhë të huaj

paraqitet si më poshtë vijon (në LEK):

	2016	2015
USD	128.17	125.79
EUR	135.23	137.28
GBP	157.56	186.59
CHF	126.05	126.74

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivet dhe detyrimet e Bankës në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të këmbyerë në LEK '000.

31 dhjetor 2016	LEKE	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	2,235,273	3,112,097	485,640	6,398	5,839,408
Hua dhe paradhënie bankave	270,019	946,757	22,178	-	1,238,954
Instrumente financiare të disponueshme për shitje	2,733,834	136,472	-	-	2,870,306
Hua dhe paradhënie klienteve	10,182,788	8,889,631	822,032	-	19,894,451
Aktive të tjera financiare	288,707	36,403	1,230	-	326,340
Totali i aktiveve financiare	15,710,621	13,121,360	1,331,080	6,398	30,169,459
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave	6,030	6,982	128,214	-	141,226
Detyrime ndaj klientëve	16,241,833	9,773,634	1,279,727	6,934	27,302,128
Detyrime të tjera ndaj klientëve	118,337	88,065	13,624	66	220,092
Borxh i varur	-	697,875	-	-	697,875
Totali i detyrimeve financiare	16,366,200	10,566,556	1,421,565	7,000	28,361,321
Pozicioni valutor në bilanc, neto	(655,579)	2,554,804	(90,485)	(602)	1,808,138
Angazhimet dhe garancitë jashtë bilancit	1,156,169	1,354,704	92,834	-	2,603,707

31 dhjetor 2015	LEKE	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	2,203,039	2,820,323	545,515	9,064	5,577,941
Hua dhe paradhënie bankave	-	1,374,537	21,766	-	1,396,303
Instrumente financiare të disponueshme për shitje	2,247,594	138,379	-	-	2,385,973
Hua dhe paradhënie klienteve	12,379,990	8,835,611	1,213,053	-	22,428,654
Aktive të tjera financiare	175,407	203,764	87,990	-	467,161
Totali i aktiveve financiare	17,006,030	13,372,614	1,868,324	9,064	32,256,032
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave	202,919	2,767	188,702	-	394,388
Detyrime ndaj klientëve	17,455,542	9,436,624	1,639,823	8,460	28,540,449
Detyrime të tjera ndaj klientëve	68,346	176,149	19,974	228	264,697
Borxh i varur	-	712,116	-	-	712,116
Totali i detyrimeve financiare	17,726,807	10,327,656	1,848,498	8,688	29,911,650
Pozicioni valutor në bilanc, neto	(720,777)	3,044,958	19,824	376	2,344,382
Angazhimet dhe garancitë jashtë bilancit	1,358,084	1,407,945	353,238	-	3,119,268

Analiza e ndjeshmërisë së Bankës merr në konsideratë lëvizjet historike të kursit të këmbimit për një periudhë 7 vjeçare në LEK kundrejt monedhave të huaja, Euro dhe USD. Këto janë normat e ndjeshmërisë të cilat përdoren për raportimin e riskut të kursit të këmbimit tek drejtuesit kryesor. Në bazë të metodave statistikore, ato përfaqësojnë vlerësimin e drejtimit për ndryshimin e mundshëm të arsyeshëm të kursit të këmbimit.

Llogaritja e kapitalit ekonomik të nevojshëm për të mbuluar riskun e monedhës tregon ndikimin që një tronditje historike ekstreme në kursin e këmbimit do të ketë për Bankën duke patur parasysh ekspozimin ndaj riskut të monedhës. Sipas skenarit standard, llogaritja e ndikimit të tillë në bazë të të dhënave më 31 dhjetor 2016, tregon për një efekt prej 90.973 mijë leke (673 mijë euro) ((2015: 91.215 mijë lekë (665 mijë euro).

(ii) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit specifikon rrezikun se lëvizjet në normat e interesit të tregut do të ndikojnë negativisht në vlerën ekonomike të Bankës dhe fitimet e saj të interesit dhe përfundimisht kapitalit. Banka nuk ka për qëllim nxjerrjen e fitimeve nëpërmjet spekulimit në tregun e normës së interesit. Përkundrazi, ajo kërkon të sigurojë që struktura e saj e normës së interesit të jetë e balancuar

në mënyrë të mjaftueshme në të gjitha maturitetet duke qëndruar brenda kufijve të përcaktuar në politikën e menaxhimit të riskut të normës së interesit dhe udhëzimit të Bankës Qendrore mbi menaxhimin e riskut të normës së interesit. Banka e arrin këtë duke rakorduar profilet e rivlerësimit midis aktiveve dhe pasiveve.

Për të monitoruar ndryshimet e normave të interesit, Banka zbaton një analizë të gap-it të ricimit dhe kap ndikimin në vlerën ekonomike (perspektivë afatgjatë) dhe ndikimin mbi të ardhurat (perspektivë afatshkurtër) që rrjedhin nga një goditje teke (zhvendosje paralele e kurbës të yield-it) të lartë mjaftueshëm për të mbuluar skenarët e ndryshëm të lëvizjeve të kurbës të yield-it; kjo është bërë për të gjitha monedhat përkatëse të riskut të normës së interesit. Duke vlerësuar të dy treguesit në të njëjtën kohë, është e mundur të përcaktohet qëllimi i plotë i ekspozimit ndaj riskut të normës së interesit.

Duke marrë parasysh strukturat e aktiveve dhe pasiveve të shprehura në EUR dhe USD deri më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të normave të interesit në normën e aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme, profili i riskut të normës së interesit të Bankës është paraqitur më poshtë:

Efekti i Fitimit(humbjes) të përlogaritur	2016		2015	
	200 bp	100 bp	200 bp	100 bp
Normat e tregut për këmbimin LEK	141,660	70,830	82,637	41,319
Normat e tregut për këmbimin EUR	71,615	35,807	69,082	34,541
Normat e tregut për këmbimin USD	2,392	1,196	5,167	2,584
Efekti total	215,667	107,833	156,886	78,444
Në % të kapitalit	4.00%	2.00%	2.92%	1.46%

Impakti i Vlerës Ekonomike	2016		2015	
	200 bp	100 bp	200 bp	100 bp
Normat e tregut për këmbimin LEK	81,126	40,563	4,084	2,042
Normat e tregut për këmbimin EUR	84,688	42,344	70,695	35,347
Normat e tregut për këmbimin USD	630	315	4,259	2,130
Efekti total	166,444	83,222	79,038	39,519
Në % të kapitalit	3.09%	1.54%	1.47%	0.73%

Tabelat e mëposhtme paraqesin në mënyrë të përbledhur ekspozimin e Bankës ndaj riskut të normës së interesit. Tabelat e mëposhtme përfshijnë gjithashtu aktivet dhe detyrimet e Bankes me norma fikse të interesit si dhe me norma të ndryshueshme interesi.

31 dhjetor 2016	Deri në 1 muaj	1 – 3 Mujore	3 – 6 Mujore	6 – 12 Mujore	Mbi një vit	Pa interes	Totali
Aktive							
Mjete monetare dhe llogari me Bankën	2,571,013	–	–	–	–	3,268,395	5,839,408
Hua dhe paradhënie bankave dhe Institucioneve të tjera financiare	540,460	135,230	270,460	270,460	–	22,344	1,238,954
Instrumente financiare të disponueshme për shitje	435,230	689,570	700,000	800,000	271,300	(25,794)	2,870,306
Hua dhe paradhënie për klientët	2,991,981	2,028,976	3,629,129	6,079,957	6,600,464	(1,436,056)	19,894,451
Aktive të tjera financiare	–	–	–	–	–	326,340	326,340
Totali i aktiveve financiare	6,538,684	2,853,776	4,599,589	7,150,417	6,871,764	2,155,229	30,169,459
Detyrimet							
Detyrimet ndaj bankave	128,170	–	–	–	–	13,056	141,226
Detyrime ndaj klientëve	6,300,261	1,592,649	2,084,197	5,482,694	1,800,055	10,042,272	27,302,128
Detyrime të tjera ndaj klientëve	–	–	–	–	–	220,092	220,092
Borxh i varur	676,150	–	–	–	–	21,725	697,875
Totali i detyrimeve financiare	7,104,581	1,592,649	2,084,197	5,482,694	1,800,055	10,297,145	28,361,321
Gap-i i ndjeshmërisë së interesit	(565,897)	1,261,127	2,515,392	1,667,723	5,071,709	(8,141,916)	1,808,138

31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	1 – 3 Mujore	3 – 6 Mujore	6 – 12 Mujore	Mbi një vit	Pa interes	Totali
Aktive							
Mjete monetare dhe llogari me Bankën	2,601,873	–	–	–	–	2,976,068	5,577,941
Hua dhe paradhënie bankave dhe Institucioneve të tjera financiare	–	–	686,400	686,400	–	23,503	1,369,303
Instrumente financiare të disponueshme për shitje	157,280	1,381,300	470,610	389,510	–	(12,727)	2,385,973
Hua dhe paradhënie për klientët	2,758,796	2,524,970	4,670,224	7,491,976	6,588,866	(1,624,178)	22,428,654
Aktive të tjera financiare	–	–	–	–	–	467,161	467,161
Totali i aktiveve financiare	5,517,949	3,924,270	5,827,234	8,567,886	6,588,866	1,829,827	32,256,032
Detyrimet							
Detyrimet ndaj bankave	394,363	–	–	–	–	25	394,388
Detyrime ndaj klientëve	7,636,951	2,006,797	2,431,096	6,031,665	1,171,174	9,262,766	28,540,449
Detyrime të tjera ndaj klientëve	–	–	–	–	–	264,697	264,697
Borxh i varur	–	–	–	–	686,400	25,716	712,116
Totali i detyrimeve financiare	8,031,314	2,006,797	2,431,096	6,031,665	1,857,574	9,553,204	29,911,650
Gap-i i ndjeshmërisë së interesit	(2,513,365)	1,917,473	3,396,138	2,536,221	4,731,292	(7,723,377)	2,344,382

(c) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e Bankës për të përmbushur plotësisht detyrimet për pagesat e saj aktuale ose të ardhshme. Prandaj Banka duhet të ruajë në çdo kohë fonde të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e saj, edhe në rrethanma potenciale të jashtëzakonshme. Risku i likuiditetit është gjithashtu risku se financimi shtesë mund të mos merret, ose mund të rimerret me normë interesi tregu më të lartë. Ai mund të shkaktohet nga çrregullimi i tregut dhe përkeqësimi i huasë i cili mund të bëjë që disa fonde financimi mos të jenë të disponueshme. Për të zbutur dhe zvogëluar riskun e likuiditetit, Banka diversifikon burimet e financimit dhe administron me kujdes aktivet e likuiditetit, duke ruajtur një gjendje të mjeteve monetare dhe të ngjashme të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e menjëhershme për përmbushje detyrimi.

Komiteti i Administrimit të Riskut të Bankës rishikon të gjitha pozicionet e normës së interesit në të gjithë monedhat e rëndësishme të paktën çdo 3 muaj ose përpara transaksioneve të konsiderueshme që mund të ndikojnë riskun e normës së interesit të Bankës. Komiteti i Aktivit dhe Pasivit dhe Komiteti i Administrimit të Riskut të Bankës ka autoritetin për të miratur modifikimet e ekspozimit brenda limiteve të përcaktuara në këtë politikë. Limitet me të larta janë të mundshme vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe janë subjekt i miratimit të Komitetit të Aktivit dhe Pasivit dhe Komitetit të Administrimit të Riskut të Grupit.

Banka synon të ruajë pozitiv gap-in e maturimit kumulativ të pritshëm. Nëse gapi i maturimit kumulativ nuk do të jetë pozitiv, Banka e konsideron likuiditetin si një “pozicion likuiditeti në mbikqyrje”.

Për qëllime likuiditeti, Banka klasifikon depozitat pa afat dhe depozitat e kursimit si depozita të cilat do të likuidohen në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe në afatin e maturimit brenda një muaji. Për rrjedhojë, është rritur gap-i kontraktor i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj. Megjithatë, mundësitë që nga Banka do të largohen shuma të mëdha të depozitave të klientëve janë shumë të pakta. Për këtë arsye, Banka nuk vlerëson të ketë një gap likuiditeti në planin afatshkurtër. Ajo fokusohet më shumë në gap-in e pritshëm të maturimit i cili përfaqëson një skenar më të mundshëm. Drejtimi i Bankës monitoron raportet e likuiditetit të Bankës kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullatorë çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj. Si rrjedhojë Drejtimi beson se Banka nuk ka asnjë gap të likuiditetit afatshkurtër.

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturimit konkret deri në datën e raportimit dhe sipas maturimit të pritshëm.

31 dhjetor 2016	Deri në 1 muaj	1 – 3 muaj	3 – 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave	141,226	–	–	–	141,226
Detyrimet ndaj klientëve	16,196,515	1,577,748	7,522,800	2,005,065	27,302,128
Detyrime të tjera	255,748	–	–	–	255,748
Borxh i varur	21,725	–	–	676,150	697,875
Totali i detyrimeve	16,615,214	1,577,748	7,522,748	2,681,215	28,396,977
Totali i aktiveve	9,850,399	1,191,924	5,868,169	14,721,802	31,632,294
Detyrimet kontigjente					
Garanci financiare	511,360	–	–	–	511,360
Angazhime të revokimit të huasë	2,092,347	–	–	–	2,092,347
Gap-i likuiditetit	(4,161,108)	(385,824)	(1,654,631)	12,040,587	5,839,024
Gap-i kumulativ	(4,161,108)	(4,546,932)	(6,201,563)	5,839,024	–
31 dhjetor 2015					
Detyrimet					
Detyrimet ndaj bankave	394,388	–	–	–	394,388
Detyrimet ndaj klientëve	16,777,857	2,036,150	8,531,548	1,194,894	28,540,449
Detyrime të tjera	313,199	–	–	–	313,199
Borxh i varur	–	–	–	712,116	712,116
Totali i detyrimeve	17,485,444	2,036,150	8,531,548	1,907,010	29,960,152
Totali i aktiveve	6,437,942	2,932,343	7,389,544	9,858,956	26,618,785
Detyrimet kontigjente					
Garanci financiare	737,934	–	–	–	737,934
Angazhime të revokimit të huasë	2,381,333	–	–	–	2,381,333
Gap-i likuiditetit	(7,928,235)	896,193	(1,142,004)	7,951,946	(222,100)
Gap-i kumulativ	(7,928,235)	(7,032,042)	(8,174,046)	(222,100)	–

(d) Risku operacional

Menaxhimi e riskut operacional është një fushë e veçantë në menaxhimin e përgjithshëm të riskut të ProCredit Bank. Proceset e administrimit të riskut operacional janë të integruara në aktivitetet ditore të menaxhimit të riskut dhe zbatohet në të gjitha nivelet. Risku operacional është përcaktuar si risku i humbjes si rezultat i proceseve të brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, nga njerëzit dhe sistemet, ose nga ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin riskun ligjor, si dhe riskun e reputacionit.

Objektivat e përgjithshëm të qasjes së ProCredit Bank në menaxhimin e risqeve operacionale janë:

- Të kuptojë nxitësit e riskut operacional
- Të jetë në gjendje të identifikojë çështjet kritike sa më parë të jetë e mundur

- Të shmange humbjet e shkaktuara nga risku operacional

Për këtë arsye Banka ka marrë vendimet strategjike si më poshtë:

- Banka do të punojë me një shkLEKë të lartë të thjeshtësisë, transparencës, dhe diversifikimi. Theksi duhet të vihet në komunikimin e hapur, vlerat e korporatave dhe besnikërinë e stafit
 - Ndarja e detyrave dhe "parimi i katër syve" do të zbatohet kudo që është e nevojshme
 - Proceset duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar
 - Auditimi i brendshëm kryen shqyrtime të rregullta
 - Fokus i fortë do të vendoset në kulturën e korporatës dhe zhvillimin e stafit
 - Banka do të zbatojë standarde të larta teknike në aspektin e hardueret, softueret IT dhe sistemet teknike backup
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut Operacional ndihmon Bordin Menaxhues në menaxhimin e riskut operacional siç përcaktohet nga politika e brendshme përkatëse, si edhe ajo e Bankës Qendrore.

(e) Administrimi i kapitalit

Objektivat e Bankës për administrimin e kapitalit, i cili është koncepti më i gjerë se kapitali aksionar në paraqitjen e bilancit, janë:

- të respektojë kërkesat e kapitalit të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë;
- të ruajë dhe të mbrojë aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin në mënyrë që mund të vazhdojë kështu të gjenerojë të ardhura për aksionerët dhe përfitime për grupet e tjera të interesit;
- të ruajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktivitetit të saj të biznesit.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo ditë nga drejtimi i Bankës, duke përdorur teknika në bazë të udhëzimeve që janë zhvilluar nga Komiteti i Bazelit dhe Direktivat e Komunitetit Evropian, të cilat zbatohen nga Banka e Shqipërisë për qëllime mbikëqyrëse. Informacioni i kërkuar paraqitet çdo tremujor pranë Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë kërkon që Banka ose Grupi Bankar duhet të (a) ruajë një nivel minimal të kapitalit rregullator prej LEK 1 miliard, si dhe (b) të ruajë një raport të totalit të kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me risk në nivelin ose mbi nivelin minimal të pranuar gjerësisht në arenën ndërkombëtare prej 12% .

Kapitali rregullator është kapitali i Bankës, i llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së Bankës së Shqipërisë, për mbulimin e riskut të kredisë, riskun e tregut dhe riskun operacional. Kapitali rregullator i Bankës është e ndarë në dy nivele. Banka llogarit kapitalin rregullator si shuma e kapitalit të Nivelit 1 dhe kapitalit të Nivelit 2, duke pasur parasysh zbritjet sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Banka llogarit ekspozimet të ponderuara me risk si shuma e elementeve të mëposhtme:

- Zëra për ekspozime apo ekspozime të mundshme të ponderuara të kreditit, ose risqe të kundërpalëve;
- Kërkesat e kapitalit për riskun e tregut; dhe
- Kërkesat e kapitalit për riskun operacional.

Tabela e mëposhtme përmbledh përbërjen e kapitalit rregullator dhe raportet e Bankës për vitet mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Gjatë këtyre dy viteve, Banka është në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë.

Kapitali Niveli 1	2016	2015
Kapitali aksionar	3,387,148	3,387,148
Rezerva statutorë	707,671	699,829
Diferencat nga konvertimi	88,091	140,773
Humbje të akumuluar statutorë (duke përfshirë fitimin për periudhën)	63,891	(278,397)
Aktive statutorë jo-materiale	(128,881)	(155,351)
Totali i kapitalit të kualifikuar Niveli 1	4,117,920	3,794,002
Kapitali Niveli 2		
Detyrime të varura	697,875	712,116
Zbritje të tjera	(163,581)	(224,309)
Totali i kapitalit të kualifikuar Niveli 2	534,294	487,807
Totali i kapitalit rregullator	4,652,214	4,281,809
Totali i aktiveve me risk të matur	28,728,065	27,505,856
Raporti CAR	16.19%	15.57%

Mjaftueshmëria e kapitalit është monitoruar gjithashtu duke përdorur një metodë uniforme të përlogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit për të gjithë grupin ProCredit në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Bazelit (Basel II). Menaxhimi Kapitali i Bankës është i qeverisur nga Politika e Bankës për Menaxhimin e Kapitalit dhe Politikës së Bankës për Kapacitetin e Mbartjes së Riskut.

Raportet rregullatore dhe Basel II të kapitalit, raporti i shfrytëzimit të Nivelit 1 dhe kapaciteti i mbartjes së riskut monitorohen në baza mujore nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut të Bankës dhe Komiteti i Menaxhimit të Riskut të Grupit.

Bazuar në këto metoda, gjatë vitit 2016, Banka ka arritur një raport të mjaftueshmërisë mbi minimumin e kërkuar i cili më 31 dhjetor 2016 është përlogaritur në 18.90% (2015: 18.26%).

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të cilat tregtohen në tregje aktive bazohen në çmimet e kuotuar të tregut ose në kuotimet e çmimit nga agjentët. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare Banka përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit.

Për instrumentet financiare të cilat nuk tregtohen shpesh dhe kanë një transparencë të vogël për çmimin, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimit dhe risqe të tjera të cilat prekin një instrument të caktuar.

(a) Modelet e vlerësimit

Banka mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila pasqyron rëndësinë e informacioneve dhe të dhënave që përdoren për realizimin e matjeve dhe vlerësimeve. Niveli 1: informacione dhe të dhëna që janë çmimet e kuotuar të tregut (të parregulluara) në tregjet aktive për instrumente të ngjashme. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë gati dhe ofrohen rregullisht nga një agjent këmbimi, agjent ndërmjetësi, bankë, shërbim për përcaktimin e çmimit ose nga një agjenci rregullatore, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksionet aktuale dhe të rregullta të cilat ndodhin në treg në mënyrë të pavarur.

Niveli 2: informacione dhe të dhëna të ndryshme nga çmimet e kuotuar që përfshihen në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Teknikat e vlerësimit që janë aplikuar i referohen vlerës së drejtë aktuale të instrumenteve të ngjashme dhe analizës së zbritjes së fluksit të parasë duke përdorur parametrat që vëzhgohen në treg.

Niveli 3: informacione dhe të dhëna të cilat nuk janë të vëzhgueshme. Nëse normat e tregut të vëzhgueshme nuk janë të disponueshme, normat e brendshme përdoren si të dhëna për modelin e zbritjes së fluksit të parasë. Normat e brendshme përcaktohen duke marrë në konsideratë koston e fondeve në varësi të monedhës dhe afatit të maturimit plus marzhin e riskut. Normat e brendshme krahasohen rregullisht me normat që aplikohen për transaksione të palëve të treta dhe janë në përputhje me parametrat për një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg sipas kushteve të tregut në datën e matjes.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e zbritjes së fluksit të parasë, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhgueshme të tregut, ose modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe informacioni që përdoret në teknikat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa risk dhe krahasues, spread-et e kredisë dhe prime të tjera të cilat përdoren për të vlerësuar dhe formuar normat e zbritjes, çmimet e obligacionit dhe kapitalit, kursin e këmbimit valutor, kapitalin dhe çmimet e indeksit të kapitalit, si dhe luhatshmëria dhe ndërlidhja e pritshme e çmimit.

Objekti i teknikeve të vlerësimit është të arrijmë të matim vlerën e drejtë e cila pasqyron çmimin që do të rezultojë për të shitur aktivin ose për të paguar transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjërësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të zakonshme dhe më të thjeshta, si norma e interesit dhe këmbimet valutore sëpaz të cilat përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe nevojiten gjykime dhe çmuarje të vogla nga drejtimi. Çmimet e vëzhgueshme ose informacioni i modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për letrat me vlerë të listuara të borxhit dhe të kapitalit.

Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të tregut të vëzhgueshme dhe informacioni i modelit zvogëlon nevojën për gjykimin dhe çmuarjen e drejtimit si dhe zvogëlon gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të tregut të vëzhgueshme dhe informacioni ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është subjekt ndryshimi në bazë të ngjarjeve të veçanta ose kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

(b) Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën klasifikohet matja e vlerës së drejtë. Këto vlera të drejta njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Letra me vlerë të disponueshme për shitje (borxh)				
	Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Gjendja më 31 dhjetor 2016				
Bono Thesari	2,460,696	-	2,460,696	-
Obligacione	409,395	-	409,395	-
Aksione	215	-	215	-
Totali	2,870,306	-	2,870,306	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015				
Bono thesari	2,247,595	-	2,247,595	-
Obligacione	138,161	-	138,161	-
Aksione	217	-	217	-
Totali	2,385,973	-	2,385,973	-

(c) Instrumentet financiare jo të matura me vlerën e drejtë

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e drejta të instrumenteve financiare të matura jo me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën klasifikohet çdo matje e vlerës së drejtë.

2016	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë	
		Niveli 2	Niveli 3
Mjete financiare			
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,839,408	5,839,408	-
Hua dhe paradhënie klienteve	19,894,451	-	20,042,090
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,238,954	1,238,954	-
Mjete të tjera financiare	326,340	326,340	-
Detyrime financiare			
Detyrime ndaj bankave	141,226	141,226	-
Detyrime ndaj klientëve	27,302,129	15,066,592	12,472,829
Borxhi i varur	697,875	-	697,875
Detyrime të tjera financiare	220,092	220,092	-

2015	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë	
		Niveli 2	Niveli 3
Mjete financiare			
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,577,941	5,577,941	-
Hua dhe paradhënie klienteve	22,428,654	-	22,577,526
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,396,303	1,396,303	-
Mjete të tjera financiare	467,161	467,161	-
Detyrime financiare			
Detyrime ndaj bankave	394,388	394,388	-
Detyrime ndaj klientëve	28,540,449	15,476,982	13,389,828
Borxhi i varur	712,116	-	712,116
Detyrime të tjera financiare	264,697	264,697	-

Sipas rastit, vlera e drejtë e huave dhe paradhënies bazohet në transaksionet evidentueshme në treg. Nëse nuk ka transaksione të evidentueshme në treg, vlera e drejtë përcaktohet me anë të teknikave të vlerësimit. Informacionet që përdoren në teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme nga huatë, normat e interesit dhe komisionet e parapagimit. Për të përmirësuar përllogaritjen e vlerësimit për huatë e individëve dhe tregtare, huatë homogjene grupohen në portofole më të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientet përcaktohet me anë të teknikave të fluksit të parasë, duke aplikuar norma të cilat ofrohen për depozita me maturim dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave që paguhen sipas kërkesës është shuma e cilat paguhet në datën e raportimit.

7. Të ardhurat nga interesi neto

Të ardhurat nga interesi janë gjeneruar nga aktivet e mëposhtme

	2016	2015
Të ardhurat nga interesat		
Hua dhe paradhënie klientëve	1,560,330	2,059,548
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	49,039	86,836
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	22,446	35,069
Totali i të ardhurave nga interesi	1,631,815	2,181,453
Shpenzime për interesat		
Detyrime ndaj klientëve	(201,430)	(284,834)
Shpenzimet për interesat e borxheve të varura	(45,223)	(119,206)
Të tjera	(5,481)	(5,115)
Totali i shpenzimeve për interesat	(252,134)	(409,155)
Te ardhura nga interesat neto	1,379,681	1,772,298

Të ardhurat nga interesat e huave dhe paradhënies për klientet për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 arrijnë vlerën totale prej LEK 30,753 mijë (2015: LEK 48,806 thousand) duke iu referuar të ardhurave prej efektit zgjidhës të kredive të demtuara.

8. Të ardhurat nga komisionet, neto

Të ardhura nga komisionet përbehen si më poshtë:

	2016	2015
Transfertat e parave dhe çeqet	75,487	105,027
Komisionet e mirëmbajtjes së llogarisë	114,716	117,717
Komisionet e kartave	87,986	90,098
Letër Kreditë dhe garancitë	1,539	766
Komisionet e shërbimeve bankare	24,630	31,428
Të tjera	9,030	11,605
Totali i të ardhurave nga komisionet	313,388	356,641
Komisionet e transaksioneve	(6,826)	(5,722)
Komisionet e kartave	(93,063)	(82,451)
Të tjera	(15,650)	(16,135)
Totali i shpenzimeve për komisionet	(115,539)	(104,308)
Të ardhura nga komisionet, neto	197,849	252,333

9. Të ardhura të tjera operative, neto

	2016	2015
Kthimi i huave të fshira më parë	9,284	87,393
Të ardhura nga shitja e aktiveve fikse	22,617	8,251
Shitja e pronave të përvetësuara përmes procesit ligjor	1,170	577
Të tjera	89,167	84,957
Totali	132,205	181,178

Të gjitha kthimet e huave të fshira më parë lidhen me hua dhe paradhënie të klientëve.

10. Shpenzime të tjera operative

	2016	2015
Zhvierësimi i aktiveve fikse	153,630	136,653
Shpenzime qiraje	102,607	114,354
Konsulencë, shërbime ligjore dhe shërbime të tjera	112,587	101,582
TI, mirëmbajtje dhe riparime	291,321	236,639
Telefon dhe energji elektrike	84,857	90,097
Sigurimi i depozitave ASD	81,272	89,415
Reklama	16,888	26,601
Shpenzime transporti dhe udhëtime	57,799	74,576
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	33,664	34,641
Shërbimet e sigurisë	25,897	26,798
Trajnime	34,013	23,957
Artikuj kancelarie zyre	18,164	12,376
Sigurimi	10,793	12,453
Fshirja e aktiveve të marra në pronësi	14,769	11,414
Shpenzime të tjera operative	122,379	115,694
Totali	1,160,640	1,107,250

11. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen si më poshtë:

	2016	2015
Pagat	398,998	456,384
Sigurimet shoqërore	33,555	12,867
Plan i i kontributeve të përcaktuara	14,380	53,091
Të tjera	6,912	5,854
Totali	453,845	519,222

Më 31 dhjetor 2016 Banka kishte 258 punonjës (31 dhjetor 2015: 309 punonjës).

12. Tatimi mbi fitimin

(a) Shumat e njohura në pasqyrën e të ardhurave

Tatimi mbi fitimin për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2016 and 2015 paraqitet si më poshtë:

	2016	2015
Te drejta tatimore afatshkurtra	14,720	50,373
Shpenzime për të drejtat tatimore të shtyra	5,978	(149)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	20,698	50,224

Tatimi mbi fitimin llogaritet në baze të rregulloreve për tatimin mbi fitimin të zbatueshme në Shqipëri, duke përdorur normat e taksave në fuqi në datën e raportimit. Norma e tatimit për tatimin mbi fitimin është 15% (2015: 15%).

(b) Shumat e njohura në Pasqyrën e të ardhurave të tjera permbledhëse("OCI")

	2016		2015	
	Përpara tatimit	Neto përpara tatimit	Përfitimi i tatimit	Neto i tatimit
Investime	(21,873)	3,281	(18,592)	7,661
në letra me vlerë të disponueshme për shitje				(1,149)
Totali	(21,873)	3,281	(18,592)	6,512

(c) Rakordimi i normës së zbatueshme të tatimit mbi fitimin

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kuadrimi dhe rakordimi i tatimit mbi fitimin i cili është llogaritur me normën e zbatueshme të tatimit me shpenzimet për tatimin mbi fitimin.

	Norma e tatimit	2016	Norma e tatimit	2015
Fitimi përpara tatimit		29,454		207,082
Tatimi teorik i llogaritur në 15%	15%	4,418	15%	31,062
Shpenzime të panjohura	35%	10,302	9%	19,311
Ndryshimi i gjendjes së të drejtave tatimore të shtyra (të panjohura)	20%	5,978	-	(149)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	70%	20,698	24%	50,224

(d) Ndryshimi i gjendjes së të drejtave tatimore të shtyra

Te drejtat tatimore të shtyra llogariten në baze të normës së tatimit në fuqi prej 15% (2015: 15%)

	Ndryshimet		Ndryshimet	
	2014	Në fitime/Në OCI ose humbje	2015	Në fitime/Në OCI ose humbje
Aktivitet/Detyrimet tatimore të shtyra neto				
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	723	- (1,149)	(426)	- 3,281
Zhvlërimi kontabël	9,03	(3,146)	- 5,884	(2,044)
Zhvlërimi i pronave të marra në zotërim	8,197	1,463	- 9,660	1,616
Provizione të tjera	3,105	1,832	- 4,937	(5,550)
Aktivitet/Detyrimet tatimore të shtyra neto	21,055	149	(1,149)	20,055
				(5,978)
				3,281
				17,358

13. Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore

Mjetet monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore përbëhen nga sa më poshtë vijon:

	2016	2015
Arka	1,327,511	1,210,161
Llogari rrjedhëse me jo-rezidentë	1,923,847	1,722,443
<i>Llogari me Bankën Qendrore</i>		
Llogari rrjedhëse	16,858	43,024
	3,268,216	2,975,628
Rezervat statutorë	2,571,192	2,602,313
Totali	5,839,408	5,577,941

Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore përbëjnë depozitën minimale të rezervës sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë. Këto rezerva llogariten si 10% të shumës së detyrimeve ndaj klientëve dhe mbahen në LEK dhe monedhë të huaj (kryesisht USD dhe EUR). Mjetet monetare dhe të ngjashme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Mjetet monetare dhe të ngjashme	3,268,216	2,975,628
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare me maturim tre mujor ose më pak (shënim 14)	675,709	-
Totali	3,943,925	2,975,628

14. Hua dhe paradhënie institucioneve financiare

Huat dhe paradhënie për institucionet financiare paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Llogaritë e depozitës me jo-rezidentë	1,216,776	1,374,537
Llogari të tjera	22,178	21,766
Totali	1,238,954	1,396,303

Huat dhe paradhënie për banka dhe institucione të tjera financiare që janë përfshirë tek mjetet monetare dhe të ngjashme (shënim 13) kanë një vlerë prej LEK 675,709 (2015: nil). Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, të gjitha këto depozita kanë maturime deri në një vit.

15. Hua dhe paradhënie klientëve

Huat dhe paradhënie për klientët përbëhen nga sa më poshtë vijon:

	2016	2015
Hua klientëve	16,075,190	18,015,548
Paradhënie bankare	5,137,839	5,867,419
Kartat e kreditit	49,490	67,541
Interesi i fituar	125,114	170,474
	21,387,633	24,120,982
Humbjet nga zhvlërimet për hua dhe paradhënie	(1,493,182)	(1,692,328)
	19,894,451	22,428,654

Lëvizjet në zbritjet për humbje zhvlërimi të huave dhe paradhënieve klientëve paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	1,692,328	1,697,316
Zhvlërimi për periudhën	60,444	355,041
Hua të fshira	(212,946)	(298,606)
Efektet e këmbimeve	(46,644)	(61,423)
Totali	1,493,182	1,692,328

Të gjitha kreditë janë të shprehura në LEK, EUR and USD dhe mbartin interesa sipas normave të interesit si më poshtë vijon:

	2016	2015
Hua në LEK	2% to 21%	2.5% to 24%
Hua në EURO	2% to 12.75%	3% to 15%
Hua në USD	2% to 12.75%	2.5% to 14%

16. Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Instrumentet financiare letrat me vlerë të disponueshme për shitje përbëhen nga bono thesari dhe obligacione dhe paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Bono thesari	2,460,696	2,247,595
Obligacione	409,396	138,161
	2,870,092	2,385,756
Aksione	214	217
Totali	2,870,306	2,385,973

Që prej 31 dhjetor 2016, Banka mban një bono nga German Nordrhein-Ēestfalen, i shprehur në

EUR, dhe me vlerësimin AAA bazuar në vlerësimin Fitch (me maturim në tetor 2018) dhe dy Bono të tjera të Qeverisë Shqiptare në Lek (me maturim në shkurt dhe mars 2018).

Lëvizja në letrat me vlerë të investimit paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	2,385,756	3,301,694
Shtesat	2,731,996	2,267,766
Maturime	(2,196,857)	(3,171,062)
Ndryshimi në interesin e fituar	(28,930)	(20,303)
Fitimi nga ndryshimet në vlerën e drejtë	(21,873)	7,661
Totali	2,870,092	2,385,756

Fitimi (humbja) i vlerës së drejtë që rezulton gjatë vitit paraqitet në mënyrë të përmblodhur si më poshtë vijon:

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	2,419	(4,093)
Shtesat	-	9,639
Pakësimet (riklasifikuar tek pasqyra e të ardhurave (21,873)	(21,873)	(1,978)
Shtesa/pakësime neto	(21,873)	7,661
Totali	(19,028)	2,845
Tatimi i shtyrë për rezervën e rivlerësimit të letrave me vlerë të disponueshme për shitje	3,281	(1,149)
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të disponueshme për shitje	(16,173)	2,419

Bono thesari

Të dhënat për bonot e thesarit në LEK të Qeverisë Shqiptare sipas maturimit kontraktual paraqiten si më poshtë vijon:

	2016		2015	
Emetuesi	Maturimi Yield	Vlera e mbartur	Maturimi Yield	Vlera e mbartur
Qeveria				
Shqiptare	12 months	1.28% - 3.22% 2,460,696	12 months	2.26% - 3.59% 2,247,595
		2,460,696		2,247,595

Vlerat e drejta për obligacionet e huaja bazohen në çmimet e kuotuar në treg të instrumenteve të ngjashme ose në çmimet e kuotuar nga agjenti për instrumentet financiare

17. Ndërtesat dhe pajisjet

	Toka dhe ndërtesat	Pajisje informatike dhe elektronike	Mjete	Mobilje dhe pajisje	Përmirësimet e ambjentëve me qera	Aktive në ndërtim	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2015	1,024,824	746,171	70,009	447,624	174,074	28,269	2,490,971
Shtesa	-	24,841	5,012	24,915	41,424	81,709	177,901
Pakësime	-	(46,299)	(12,633)	(54,578)	(45,775)	(15,390)	(170,675)
Transferime	20,660	19,159	6,720	10,525	6,412	(63,476)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,045,484	743,872	69,108	428,486	176,135	31,112	2,494,197
Shtesa	-	75,996	6,629	10,352	6,591	53,329	152,897
Pakësime	-	(76,401)	(15,441)	(33,150)	(47,266)	(1,734)	(173,992)
Transferime	3,634	61,190	-	2,525	-	(69,953)	(2,604)
Më 31 dhjetor 2016	1,049,118	804,657	60,296	408,213	135,460	12,754	2,470,498
Zhvlërim i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2015	(115,118)	(646,897)	(55,361)	(304,486)	(113,164)	-	(1,235,026)
Detyrime për periudhën	(21,879)	(44,220)	(6,610)	(37,024)	(24,952)	-	(134,685)
Pakësime	-	43,930	12,633	39,932	45,775	-	142,270
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(136,997)	(647,187)	(49,338)	(301,578)	(92,341)	-	(1,227,441)
Detyrime për periudhën	(22,223)	(50,412)	(9,166)	(33,955)	(34,953)	-	(150,709)
Pakësime	-	75,050	15,441	30,187	47,266	-	167,944
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(159,220)	(622,549)	(43,063)	(305,346)	(80,028)	-	(1,210,206)
Vlera kontabël neto							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	908,487	96,685	19,770	126,908	83,794	31,112	1,266,756
Gjendja më 31 dhjetor 2016	889,898	182,108	17,233	102,867	55,432	12,754	1,260,292

18. Aktive afatgjata jo-materiale

	Softueri i blerë
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2015	399,391
Shtesa	3,068
Gjendja më 31 dhjetor 2015	402,459
Shtesa	3,446
Transferime	2,603
Gjendja më 31 dhjetor 2016	408,508
Zhvlërim i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2015	(206,837)
Detyrimi për periudhën	(34,642)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(241,479)
Detyrimi për periudhën	(33,664)
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	(275,143)
Vlera kontabël neto	
Gjendja më 31 dhjetor 2015	160,980
Gjendja më 31 dhjetor 2016	133,365

19. Prona të marra në dorëzim

	2016	2015
Prona të marra në dorëzim	1,356,262	980,419
	1,356,262	980,419

Prona të marra në dorëzim janë kolateral i përfutur gjatë proceseve ligjore dhe përfshijnë tokë, ndërtesa dhe aktivitete biznesi të cilat nuk përdoren nga Banka për operacionet e saj bazë. Pronat e marra në dorëzim gjatë procesit ligjor janë për tu shitur sapo të shihet e arsyeshme (ju lutem shihni shenimin 4.a.(iii)).

Banka shkarkon plotësisht pronat e marra në dorëzim brenda 7 viteve nga vlerësimi fillestar.

Ndryshimi i aktiveve të marra në dorëzim gjatë periudhës që raportohet është paraqitur si më poshtë vijon:

	2016	2015
Gjendja në fillim të periudhës	980,419	880,138
Shtesa gjatë periudhës	430,780	258,640
Shkurtime në fund të periudhës	(40,168)	(146,945)
Të shkarkuara	(14,769)	(11,414)
Gjendja në fund të periudhës	1,356,262	980,419

20. Investime në pronë

Banka ruan Investimet në pronë si rezultat i përvetësimit përmes ekzekutimit të garancisë së huasë dhe paradhënëve të klientëve.

	Investime në pronë
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2015	65,636
Shtesa	46,982
Gjendja më 31 dhjetor 2015	112,618
Shtesa	25,014
Pakësime	(28,126)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	109,506
Zhvlëresim i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2015	(4,448)
Detyrimi për periudhën	(1,968)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(6,416)
Detyrimi për periudhën	(2,921)
Pakësime	810
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(8,527)
Vlera kontabël neto	
Gjendja më 31 dhjetor 2015	106,202
Gjendja më 31 dhjetor 2016	100,979

21. Tatimi mbi fitimin e korporates, i parapaguar

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	57,281	84,191
Pagesat e tatimit mbi fitimin	-	23,463
Tatimi mbi fitimin e korporatës për periudhën	(14,720)	(50,373)
Totali	42,561	57,281

22. Mjete të tjera

	2016	2015
Arkëtime nga transaksionet në ATM	41,274	23,074
Debitorë të tjerë	285,066	320,500
Pagesa tranzit	-	123,587
Aktive të tjera financiare	326,340	467,161
Shpenzime të parapaguara	153,309	119,300
Totali	479,649	586,461

Debitorë të tjerë, kryesisht kanë të bëjnë me parapagimet e bëra në zyrat e përmbarimit që mbledhin fonde nga konsumatorët e kredisë.

Aktivët të tjera financiarë nuk janë as të vonuara as të zhvlërsuara.

23. Detyrime ndaj bankave

	2016	2015
Hua nga bankat rezidente	-	388,710
Hua nga bankat jo-rezidente	128,214	-
Llogari rrjedhëse nga bankat rezidente	13,012	5,678
Totali	141,226	394,388

Normat e interesit për huatë nga bankat janë përcaktuar 1.25% në vit për huatë në USD (2015:1.5% në vit për huatë në LEK dhe 1.05% për huatë në USD). Llogari të tjera përfshijnë llogarite escrow.

24. Detyrime ndaj klientëve

	2016	2015
Llogari rrjedhëse		
Monedhë e huaj	5,501,122	4,855,491
Monedhë vendase	3,922,812	3,950,358
Llogari kursimi		
Monedhë vendase	3,003,488	3,498,510
Monedhë e huaj	2,050,902	2,655,923
Llogari rrjedhëse me afat		
Monedhë e huaj	2,183,022	2,469,871
Monedhë vendase	9,866,880	10,400,871
Llogari të tjera të klientëve		
Monedhë e huaj	367,825	252,831
Monedhë vend	275,854	285,972
Interes i fituar	130,223	170,622
Totali	27,302,128	28,540,449

Llogaritë e kursimit në LEK bartin një interes prej 0.5% në vit (2015: 0.8%), ndërsa llogaritë e kursimit në monedhë të huaj, përfshirë Euro dhe USD, bartin një interes prej 0.05% në vit dhe 0.1% në vit për periudhën 2016 dhe 2015. Llogari të tjera të klientëve përfshijnë llogari të vendosura si kolateral. Ato mbartin norma interesi në nivele të ngjashme me depozitat me afat.

Normat e interesit që janë aplikuar për depozitat me afat që prej 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, janë si më poshtë vijon:

(në %)	3-6 muaj	12 muaj	15-60 muaj
LEK	0.54 - 1.24	0.81 - 1.74	1.22 - 3.07
USD	0.50 - 0.55	0.70 - 0.90	0.75 - 0.80
EUR	0.05 - 0.09	0.05 - 0.14	0.10 - 0.10

(në %)	3-6 muaj	12 muaj	15-60 muaj
LEK	1.21 - 1.59	1.74 - 2.10	2.20 - 4.04
USD	0.50 - 0.55	0.70 - 0.86	0.75 - 0.90
EUR	0.05 - 0.10	0.05 - 0.10	0.10 - 0.15

25. Borxhi i varur

	2016	2015
Borxhi i varur		
ProCredit Holding	676,150	686,400
Interesi i llogaritur	21,725	25,716
Totali	697,875	712,116

Më datë 3 korrik 2014, Banka ka marrë nga ProCredit Holding AG & Co. KGaA një borxh të varur me vlerë EUR 5 million, me një norme interesi fikse prej 6.552% dhe afat maturimi në datën 3 korrik 2024. Interesi paguhet çdo 6 muaj dhe principali paguhet në datën e maturimit.

26. Detyrime të tjera

	2016	2015
Pagesa tranzit	90,584	179,017
Kreditorë të ndryshëm	118,003	69,211
Shpenzime të llogaritura	11,568	16,469
Të ardhura nga komisioni, të shtyra	610	958
Detyrime të tjera financiare	220,765	265,655
Detyrime tatimore dhe sociale	14,878	17,473
Provizione të tjera	20,104	30,071
Totali	255,747	313,199

Provizione të tjera ka të bëjë me provizionet e humbjeve për zëra jashtë bilancit dhe provizioneve të përcaktuara për rastet ligjore. Ato përfaqësojnë vlerësimet më të mira të shumave me të cilat rastet ligjore do të shlyhen në periudhat e ardhshme. Lëvizja në provizione të tjera për vitet 2015 dhe 2016 është paraqitur më poshtë:

	Zëra jashtë bilancit	Raste ligjore	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	4,047	21,469	25,516
Provizione të bëra gjatë periudhës	5,459	4,825	10,284
Provizione të anuluar gjatë periudhës	(3,179)	(2,550)	(5,729)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	6,327	23,744	30,071
Provizione të bëra gjatë periudhës	3,299	1,755	5,054
Provizione të anuluar gjatë periudhës	(4,464)	(10,557)	(15,021)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,162	14,942	20,104

27. Kapitali aksionar dhe rezervat statutore

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, kapitali aksionar i Bankës që është autorizuar dhe emtuar përbëhet nga 347,750 aksione me një vlerë totale prej EUR 25,698,725 (vlera ekuivalente në LEK 3,387,148 mijë). Kompania mëmë dhe aksioneri i vetëm i Bankës është ProCredit Holding AG & Co. KGaA ("Kompania Mëmë"), shoqëri aksionere me seli në Frankfurt am Main, Gjermani.

Rezervat statutore

Rezervat statutore janë krijuar në bazë të vendimit nr. 69, datë 18 dhjetor 2014, të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, i cili parashikon se rezervat janë krijuar përmes përvetësimit të 20% të fitimit neto të bankës për atë periudhë, sikundër raportohet për qëllime FRM. Gjithashtu, është krijuar rezerva ligjore prej 5% të fitimit statutor të parashikuar në Ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "Për sipëmarrësit dhe shoqëritë tregtare".

Rezerva e vlerës së drejtë

Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin kumulativ neto në vlerën e drejtë të investimeve të disponueshme për shitje, derisa investimi çregjistrohet, ose zhvlerësohet. Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë janë paraqitur në shënimin 16.

28. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

	2016	2015
Garanci të dhëna në favor të klientëve	511,360	737,934
Angazhime kredie të marra në favor të klientëve	2,092,347	2,381,333
Llogari të bllokuara	148,695	140,298
Totali	2,752,402	3,259,565

Banka lëshon garanci për klientët e saj. Këto instrumente mbartin një risk kreditit të ngjashëm me atë të huavetë lëshuara. Bazuar në vlerësimin e Drejtimit, nuk ka humbje materiale të papaguara të lidhura me garancitë më 31 dhjetor 2016 dhe si rrjedhojë provigjioni për humbjet nuk është përfshirë në këtë pasqyrë financiare.

Procese ligjore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm bankar, Banka përballet me procedime ligjore; Drejtimi i Bankës beson se mundësia për një rrjedhje të të ardhurave ekonomike në lidhje me pretendimet ligjore deri më 31 dhjetor 2016 është e vogël, me përjashtim të rastit kur provigjioni është regjistruar siç tregohet në shënimin 10.

Angazhime qiraje operationale

Banka merr me qira mjedise për të realizuar operacionet e saj. Në përgjithësi, kontratat e qirasë operationale mund të anulohen në bazë të një njoftimi 90 ditë përpara. Shuma maksimale e angazhimeve të qirasë operationale të cilat nuk mund të anulohen dhe duhet të paguhet jo më vonë se 1 vit është afërsisht LEK 22,581 mijë (2015: LEK 24,645 mijë). Shpenzimet e qirasë për periudhën 2016 and 2015, janë paraqitur në Shënimin 10.

29. Transaksione me palët e lidhura

Palët e lidhura të Bankës përfshijnë kompaninë mëmë ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG, filialet, drejtuesit kryesor, familjarë të drejtuesve kryesor dhe subjekte të cilat kontrollohen ose influencohen në mënyrë të konsiderueshme nga drejtuesit kryesor të Bankës ose familjarët e afërt të tyre.

Banka ka nënshkruar një kontratë shërbimi për drejtimin me ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG, për t'i siguruar Bankës punonjës dhe personel në nivele të larta drejtuese të Bankës, duke përfshirë një Anëtar të Këshillit Administrativ. Komisionet për drejtimin që janë paguar ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG në 2016, janë LEK 42,792 mijë (2015: LEK 42,509 mijë).

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të aktivitetit bankar, Banka ka kryer transaksione biznesi me palët e lidhura, gjendet dhe transaksionet me aksionerin dhe subjektet e lidhura me 31 dhjetor 2016 dhe 2014 paraqiten si më poshtë vijon:

2016	ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG	Kompani të tjera të grupit ProCredit	Totali
Aktive			
Mjete monetare dhe hua për institucionet financiare	–	2,858,961	2,858,961
Mjete të tjera	1,044	7,322	8,366
Detyrime			
Detyrime të tjera	696,789	130,948	827,737
Të ardhurat dhe shpenzimet			
Të ardhurat	–	2,290	2,290
Shpenzimet	95,379	225,664	321,043

2015	ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG	Kompani të tjera të grupit ProCredit	Totali
Aktive			
Mjete monetare dhe hua për institucionet financiare	–	2,807,518	2,807,518
Mjete të tjera	563	9,599	10,162
Detyrime			
Detyrime të tjera	710,215	2,141	712,356
Të ardhurat dhe shpenzimet			
Të ardhurat	–	5,409	5,409
Shpenzimet	100,911	160,465	261,376

Përfitimet e tjera kryesore afatshkurtra për drejtuesit paraqiten si më poshtë vijon:

	2016	2015
Pagat	17,801	21,749
Bonuset	-	4,135
Totali	17,801	25,884

30. Ngjarje pas datës së bilancit

Drejtimi i Bankës nuk ka dijeni për ndonjë ngjarje tjetër pas datës së bilancit, të cilat do të kërkonin korrigjime apo edhe shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.

Adresat dhe Kontaktet

Zyrat Qëndrore

ProCredit Bank sh.a.

Place of Registration: Tiranë

No. of Court Regist: 20797/11.02.1999

KIB: 20911005

Nipt: J 91524011J

Legal address: Rr. "Dritan Hoxha". Nd. 92,

H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11, Tiranë.

P.O. Box 1026

Tel.: +355 (0) 42 389 300

Qendra e Kontaktit:

+355 (0) 42 389 389

+355 (5) 2 293 001

informacion@procredit-group.com

www.procreditbank.com.al

Degët

Tirana Branch

Rr. "Dritan Hoxha"

Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11,

Kodi Postar 1026, Tiranë

Korça Branch

Rruga "Midhi Kostani", Korçë

Shkodra Branch

Bulevardi "Zogu I", Nr. 7, Shkodër

Agjencitë dhe Zonat 24/7

Head Office Agency, Zona 24/7

Rr. "Dritan Hoxha"

Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11,

Kodi Postar 1026, Tiranë

Tirana e Re Agency, Zona 24/7

Rr. "Sami Frashëri", Tiranë

Medrese Agency, Zona 24/7

Rr. "Ferit Xhajko"

Ndërtesa 128, H. 2

Njësia Bashkiake nr. 8, kodi Postar 1017, Tiranë

Piazza Agency, Zona 24/7

Rr. "Ded Gjo Luli", pranë Muzeut Kombëtar,

Tiranë

Rruga e Kavajës Zona 24/7

Rruga e Kavajës, Tiranë

Kombinati Agency, Zona 24/7

Rr. "Llazi Miho" Nd.95 H. 7

Njësia Bashkiake Nr. 6 Kodi Postar 1027, Tiranë

Liceu Agency, Zona 24/7

Rr. "Ismail Qemali" pranë Liceut Artistik

Durrësi 2 Agency, Zona 24/7

Lagjja Nr. 7, Rr. "Aleksandër Goga" Durrës

Durrësi Porti Agency, Zona 24/7

Lagjja 3, Rr. "Skënderbej"

Pranë Qendrës Monum (ose pranë Portit)

Shkozeti Agency, Zona 24/7

Lagjja 14, Rr. "Tirana", Stacioni 1, Shkozet, Durrës

Berati Agency, Zona 24/7

Bulevardi "Republika",

Lagjja "22 Tetori", Berat

Lushnja Agency, Zona 24/7

Lagjja "Xhevdet Nepravishta"

Shëtitorja Kryesore, pranë Poliklinikës, Lushnje

Elbasani Agency, Zona 24/7

Bulevardi "Qemal Stafa", Lagjja "Dyli Haxhire",

P. 10/1, Elbasan

Pogradeci Agency, Zona 24/7

Qendra "Kapri"

Rr. "Rreshit Collaku", Lagjja 1, Pogradec

Korça Agency, Zona 24/7

Rruga "Midhi Kostani", Korçë

Korça Zona 24/7

Bul. "Shën Gjergji", Nr.7, L.7, Korçë

Fieri Agency, Zona 24/7

Lagjja "11 janari", Rr. "Ramis Aranitasi", Fier

Vlora Agency, Zona 24/7

Lagjja "Isa Boletini", Vlorë

Shkodra Agency, Zona 24/7

Bulevardi "Zogu I", Nr. 7, Shkodër

Lezha Agency, Zona 24/7

Lagjja "Besëlidhja"

Shëtitorja "Gjergj Fishta", Lezhë

